



STUDIME POSDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“ANALIZA E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË
KONCESIONEVE TË LENDËVE MINERALE NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË, PERIUDHA (2008-2017)”**

KANDIDATI:

Hava Alili

MENTOR:

Prof.Dr. Rofi Osmani

Tetovë, 2018

Deklarata e origjinalitetit

Me përgjegjësinë time më të lartë deklaroj se ky punim me titull **“ANALIZA E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË KONCESIONEVE TË LENDËVE MINERALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, PERIUDHA (2008-2017)”** është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë, i tëri apo pjesërisht. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të citateve dhe referencave të tjera (për të cilat është ruajtur burimi/ referencat).

Emri mbiemri

dhe nënshkrimi i studentit

Tetovë, 2018

Mirënjohje dhe Falënderimet

Një rrugëtim si ky, në asnjë mënyrë, nuk do të mund të bëhej vetëm. Rrugëtim i cili shënon një tjetër arritje për mua, përfundimin e studimeve në nivelin Master.

Une jam tepër mirnjohës ndaj shumë njerëzve të cilët kanë ndarë kohë, energji dhe përpjekje për të bërë këtë hulumtim realitet. Veçanërisht dëshiroj të shpreh mirënjohjen më të thellë ndaj mentorit, Prof.Dr.Rufi Osmani, i cili më dha përkrahje profesionale dhe morale. Njëkohësisht më dha vërejtjet, udhëzimet dhe rekomandimet e tij më të sinqerta përgjatë gjithë punës sime, të cilat më ndihmuan që ky studim të jetë i suksesshëm.

Faleminderimet më të sinqerta u drejtohen antarëve të komisionit, Prof.Dr Izet Zeqiri dhe Doc.Dr Fitim Deari për bashkpunimin dhe durimin që treguan gjatë realizimit të punimit.

Falënderimet më të përzemërta u takojnë prinderve të mi, po mos të ishin ata unë nuk do të isha sot këtu, të cilët më dhanë edukimin, sjelljen më mësuan se si të përballem me sfidat e jetës, sinqerisht i falemenderoj për mbështetjen dhe inkuraimin e pafund që më mësuan të besoj në veten time, faleminderit që ishi cdokund ku unë kisha nevojë. Jam tepër mirënjohëse për mundin sakrifikicën dhe mbështetjen shpirtërisht dhe moralisht të vëllaut tim.

Një tjetër falënderim i takon Ministrisë së Ekonomisë, e cila më ofroi të dhënat e nevojshme gjatë gjithë hulumtimit ku veçanërisht e falemenderoj Dr.Ejup Latifin për kontributin, sugjerimet, rekomandimet dhe durimin që tregoi gjatë këtij rrugëtimi.

Abstrakt

Qëllimi kryesor i studimit në këtë tezë magjistrature është analiza e politikave të dhënies së koncesioneve, kushtet dhe kriteret e aplikuara nga Ministria e ekonomisë gjatë përzgjedhjes së subjekteve ekonomike me destinime të vecanta në kuadër të lëndës së hulumtimit .Në menyre specifike do të analizohen niveli i koncesioneve dhe vlera e tyre gjatë periudhës 2008-2017, kriteriumet e zgjedhjes së kompanive që do të konkurojnë për marjen e koncesionit, zonat ku ato mund të shfrytëzojnë dhe ti realizojnë eksplorimet gjeologjike në vecanti shpenzimet që ato do të paguajnë për marjen e koncesionit dhe realizimet eksploatimit në m³, ndërsa nga ana tjetër marja e koncesionit do të ndihmonte kompanitë që të realizojnë objektivat e tyre duke ritur zhvillimin e tyre dhe duke kontribuar edhe në zhvillimin ekonomik të vendit me anë të një analize krahasimore dhe interpretimit të kriteriumeve të dhënies së koncesioneve dhe indikatorëve financiar që kanë të bëjnë me dhenien e koncesioneve do të japin një pasqyrë të qartë dhe objektive rreth menyrës dhe transparencës së dhënies së koncesioneve.

Rezultatet e aritura kanë për qëllim politikat e dhënies së koncesionit në periudhën e caktuar duke u bazuar në kriteriumet e vendosur nga Ministria e Ekonomisë në dhënien e koncesioneve, ku do të përdoren metoda statistikore përmes tabelave dhe grafikëve do të jepen të dhënat relevante të koncesioneve si ato kanë qenë gjatë periudhës së dhënë konkrete, duke analizuar edhe koncesionet në bazë të qyteteve, si dhe realizimi i sistemit të pagesave dhe eksploatimet që ato do të realizojnë gjatë periudhës konkrete, gjatë analizës do të bazohemi në shpenzime –përfitime të koncesioneve si ato ndikojnë në buxhetin e shtetit dhe në PBB e vendit.

Fjalët Kyçe: Burimet minerale, koncesionet, subjektet ekonomike, transparenca

Abstract

The main purpose of this master's thesis is to analyze the concession granting policies, conditions and criteria applied by the Ministry of the Economy when selecting economic entities with special destinations within the subject of the research. Specifically, the level of concessions and their value during the period 2008-2017, the criteria for selecting the companies that will compete for the concession, the areas where they can exploit and realize the geological exploration, in particular the costs they will pay for the concession and realization exploitation in m3, while on the other hand the granting of the concession would help companies realize their objectives by increasing their development and contributing to the economic development of the country through a comparative analysis and interpretation of the concession award criteria and indicator financial issues related to the granting of concessions will give a clear and objective picture of the way and the transparency of granting concessions.

The achieved results aim at the concession granting policies in the given period based on the criteria set by the Ministry of Economy in the award of concessions, where statistical methods will be used through tables and graphs, will be given the relevant data of concessions such as they have been during the given period of time, analyzing city-based concessions as well as the realization of the payment system and the exploits that they will realize during the specific period during the analysis will be based on the cost-benefits of the concessions as they affect in the state budget and in the GDP of the country.

Key words: Mineral resources, concessions, economic entities, transparency

Апстракт

Главната цел на истражувањето во овој магистерски труд е да се анализираат политиките на доделување на концесии, условите и критериумите што се применуваат од страна на Министерството за економија во изборот на економските субјекти со посебни цели во рамките на предметот на истражување. Посебно да се анализира нивото на концесии и нивната вредност во текот на периодот 2008-2017, критериумите за избор на компании кои ќе се натпреваруваат за добивање на концесија, областите каде што тие можат да ги користат и да сфати геолошки истражувања особено трошоците кои тие ќе плаќаат за концесија за добивање и реализација на експлоатацијата во m³, додека, пак, по добивање на концесија ќе им помогне на компаниите да ги постигнат своите цели од страна на возрасните од својот развој, а исто така да придонесе за економски развој преку компаративна анализа и толкување на критериумите за доделување на концесии и финансиските индикатори поврзани со прашања при доделувањето на концесиите и ќе дадат јасна и објективна слика за начинот и транспарентноста во доделувањето на концесии.

Добиените резултати се стремат кон политиките за доделување концесии во дадениот период, врз основа на критериумите утврдени од страна на Министерството за економија при доделувањето концесии, каде што статистичките методи ќе се користат преку табели и графикони, и ќе бидат дадени релевантни податоци за концесиите како што тие биле во текот на одреден период, анализирани врз основа на концесиите по градови, како и реализација на системот на плаќање пооснов на користење, кои ќе ги изврши во текот на одреден период за време на анализата ќе се потпира на профит од концесијата и направените трошоци, како тие влијаат во државниот буџет и во БДП на земјата.

Глави зборови: минерални ресурси, концесии, економски субјекти, транспарентност

Përmbatja:

Deklarata e origjinalitetit	2
Mirënjohje dhe Falënderimet	3
Abstrakt	4
Abstract	5
Анотпакт	6
Lista e figurave	8
Lista e tabelave	9
I.HYRJE	10
Metodologjia e hulumtimit	11
Rëndësia e Punimit	11
Identifikimi i problemit	12
Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit	12
II.Legjislative juridike dhe procedura e dhënies së koncesioneve	14
Ligjet bazike dhe aktet nënligjore që rregullojnë procesin e dhënies së koncesioneve.	14
Burimet kryesore dhe ndarja e lëndëve minerale në RM	18
Mënyra e pagesës dhe niveli i tarifave të koncesioneve minerale	21
Dokumentacioni,procedura e konkurimit dhe zgjedhje e kompanive fituese	25
III.Koncesionet në vendet e Ballkanit Perëndimor	32
Procedura dhe praktikat e koncesioneve ne Republikën e Kosovës	33
Procedura dhe praktika e koncesioneve në Republikën e Shqipërisë	38
IV.Analiza dhe diskutimi i rezultateve	45
Analiza e koncesioneve të burimeve minerale si pjesë e Industrisë	49
Analiza e kriteriumeve dhe objektivat e dhënies së koncesioneve	53
Analiza e procesit të dhënies së koncesioneve sipas rajoneve dhe kompanive fituese në RM	58
Analiza e sistemit të pagesave të koncesioneve të burimeve minerale	62
Kosto-benefit analiza e koncesioneve minerale	65
Analiza e te hyrave financiare te paguara si koncesione nga mineralet në buxhetin RM-se	71
Koncesionet minerale në vendet e ballkanit perëndimor	75
Gjetjet dhe interpretimi i rezultateve	77
V.Përfundimi dhe rekomandimet	78
Referencat:	81
SHTOJCA	84

Lista e figurave

- Grafikoni 1. Të dhënat e pjesmarjes së burimeve minerale
- Grafikoni 2. Lejet e burimeve minerale në Kosovë
- Grafikoni 3. Renta minerale e realizuar në R.Kosovës 2012-2017
- Grafikoni 4. Lejet për shfrytëzim të burimeve minerale në Shqipëri
- Grafikoni 5. Nr I lejeve për dhfrytëzim të burimeve minerale në Shqipëri
- Grafikoni 6. Renta minerale sipas viteve në Shqipëri
- Grafikoni 7. PBB e sektorit të minierave në Shqipëri
- Grafikoni 8. Rritja reale ekonomike në vendet e ballkanit
- Grafikoni 9. Shfrytëzimi I burimeve minerale në Maqedoni
- Grafikoni 10. Koncesionerët më të mëdhenj të burimeve minerale
- Grafikoni 11. Të dhënat për shfrytëzimin e burimeve minerale
- Grafikoni 12. PBB dhe bruto prodhimi I burimeve minerale
- Grafikoni 13. Pjesmarja e PBB minerale në totalin e PBB
- Grafikoni 14. Indekset e prodhimit industrial në sektorin e minierave
- Grafikoni 15. Ndarja e të ardhurave nga lokaliteti "SAMARNICA"
- Grafikoni 16. Të ardhurat e përfituara nga lokaliteti "SAMARNICA"
- Grafikoni 17. Koncesionet e kompanive fituese në bazë rajonale
- Grafikoni 18. Vlera e shfrytëzimit të burimeve minerale në bazë rajonale 2008-2017
- Grafikoni 19. Vlera e koncesioneve minerale në rajonin e Pollogut
- Grafikoni 20. Vlera e koncesioneve minerale në rajonin e Shkupit
- Grafikoni 21. Të ardhurat koncesionare të paguara nga kompania "XYZ"
- Grafikoni 22. Ndarja e koncesioneve në baza rajonale
- Grafikoni 23. Të hyrat e koncesioneve minerale në buxhetin e RM
- Grafikoni 24. Të hyrat në buxhetin komunal nga koncesionet minerale
- Grafikoni 25. Grafikoni I PBB në vendet e Ballkanit perëndimor

Lista e tabelave

- Tabela 1. Të dhënat e pjesmarjes së burimeve minerale
- Tabela 2. Rezervat minerale në disa miniera në Kosovë
- Tabela 3. Lejet e koncesioneve minerale në Kosovë
- Tabela 4. Renta minerale e realizuar në Kosovë 2012-2017
- Tabela 5. Renta minerale në Shqipëri 2012-2017
- Tabela 6. Indikatorët më të rendësishëm ekonomik në RM
- Tabela 7. Të dhënat për koncesionet e burimeve minerale në Maqedoni
- Tabela 8. Vlera e shfrytëzimit të burimeve minerale të kompanive fituese në rajonin e Pollogut
- Tabela 9. Të dhënat e sistemit të pagesave të kompanisë “ABC”
- Tabela 10. Nr I koncesioneve të fituara nga subjektet ekonomike
- Tabela 11. Ndarja e koncesioneve në bazë të resurseve minerale
- Tabela 12. Të dhënat koncesionare të kompanisë “ABC”
- Tabela 13. Të hyrat nga koncesionet minerale në buxhetin e RM
- Tabela 14. Të ardhurat e komunave në bazë të koncesioneve minerale
- Tabela 15. Tabela e koncesioneve minerale në vendet e Ballkanit

HYRJE

Objektivi kryesor I hulumtimit është që të analizohet procedura dhe dhënia e koncesioneve e burimeve minerale se sa ato do të ndikojnë në ritjen ekonomike të vendit dhe zhvillimit të sektorit real ekonomik gjatë periudhës 2008-2017, zhvillimi i sektorit real është njëra nga objektivat parësore, që ndikonë në rritjen e mirëqenies së përgjithshme ekonomike ku dhënia e koncesioneve ndikon në sektorin real nëpërmjet sektorit të ndërtimtarisë, minierave, energjisë ku kontribonë në rritjen ekonomike, buxhetin e shtetit dhe PBB e vendit.

Politika e koncesioneve ka një rëndesi të madhe në R.M, mirëpo shumë pak kemi njohuri se çfarë janë koncesionet dhe çfarë përfitime mund të kemi prej tyre, ku gjatë hulumtimit do të analizojmë kriteriumet e vendosura nga ministria e Ekonomisë në aspekt të objektivitetit dhe transparences, sistemi i pagesave të koncesioneve dhe eksploatimet që kompanitë i realizojnë në një periudhë të caktuar kohore ku sektori I mineraleve paraqet njërin ndër sektorët më të mëdhej të eksportit dhe ajo kontribon rreth 1.5% në PBB e vendit.

Analiza e mineraleve është e një rëndesie të vecantë që kontribuon në mbrojtjen e mjedisit, kushtet dhe mënyra e kryerjes së eksplorimeve gjeologjike, promovimi dhe zhvillimin e eksplorimeve gjeologjike me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit optimal të tyre në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit ku koncesioni - është ndarje e së drejtës së përdorimit të të mirave me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë.

Metodologjia e hulumtimit

Realizimi i këtij punimi është i bazuar në metodat e krahasimit, në intervista dhe biseda të ndryshme me ekspert ndërkombëtar dhe vendor të kësaj lëmie. Për përgatitjen e këtij raporti është shfrytëzuar literaturë nga Ekonomia, Gjeologjia, Xehetaria, të autorëve të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar, si dhe literaturë profesionale ndërkombëtare. Sa i përket ndikimit të institucioneve tjera, hulumtimi është bazuar në ligjet ekzistuese në Maqedoni, në intervistat dhe bisedat me ekspert të ndryshëm. Po ashtu, janë shfletuar faqet e internetit që kanë të bëjnë me lëminë e industrisë minerare dhe rolin e rregullatorëve në këtë industri etj.

Rezultatet e aritura kanë për qëllim politikat e dhënies së koncesionit në periudhën e caktuar duke u bazuar në kriteriumet e vendosura nga Ministria e Ekonomisë në dhënien e koncesioneve, ku do të përdoren metoda statistikore përmes tabelave dhe grafikoneve do të jepen të dhënat relevante të koncesioneve si ato kanë qenë gjatë periudhës së dhënë konkrete, duke analizuar edhe koncesionet në bazë të qyteteve, si dhe realizimi i sistemit të pagesave dhe eksplotimet që ato do të realizojnë gjatë periudhës konkrete, gjatë analizës do të bazohemi në shpenzime –përfitime të koncesioneve si ato ndikojnë në buxhetin e shtetit dhe në PBB e vendit.

Rëndësia e Punimit

Ky punim do të jetë një kontribut me interes në lëminë e mineraleve veçmas të koncesioneve, që subjektet ekonomike arrijnë ti marrin nga ministria e Ekonomisë.

Zhvillimi ekonomik i një vendi varet nga performanca e sektorit real ekonomik dhe përmirësimin e këtij sektori dhe në rastet kur kompanitë ballafaqohen me vështirësi të ndryshme ekonomike dhe financiare, dhënia e koncesioneve në masë të madhe ndikon në sektorin real ekonomik duke rritur zhvillimin e tij dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ndikon edhe në sektorin e ndërtimit, mineraleve dhe energjisë duke e rritur mireqenien e përgjithshme ekonomike.

Politika e koncesioneve në R.M është analizuar nëpërmjet analizave të ndryshme me qëllim të evidentimit të shkaqeve dhe transparencës e kriteriumeve të vendosura nga ministria e ekonomisë në aspekt të objektivitetit dhe transparencës.

Në këtë studim do të jepet edhe një analizë dhe pikëpamje mbi aspektet ligjore në radhë të parë si dhe procesin e bërjes së pagesave të koncesioneve dhe eksplotimet që ato do të mund të realizojnë në një periudhë të caktuar.

Identifikimi i problemit

Republika e Maqedonisë ka pothuajse tre për qind nga e gjithë pasuria botërore e mineraleve. Vendi nuk ka burime të diamanteve, por për këtë arsye është e vetmja në botë që në territor të saj e ka minierën Alshar në malin Kozhuv, ku ka vend të pasur të një nga mineralet më të rralla, lorandit. Me ndihmën e tij, sipas shkencës, mund të dëshmohet se si funksionon Dielli dhe si burim i energjisë së pashtershme, në të ardhmen, të tejkalohet kriza energjetike në nivel global.

Në mineralet nga Alshar ka prezencë edhe të antimonit, arsenit dhe taliumit. Madje shtatë nga dhjetëra kristalet e rralla të regjistruar në botë, janë të pranishme në Alshar. Mineralet e çmueshme nga brendësia e Maqedonisë është rubini i cili gjithashtu është mineral, edhe pse është gur i tejudkshëm, që është indikator për shkallën e lartë të cilësisë së tij, ai tanimë është brend i Maqedonisë.¹

Koncesionet kanë një rëndësi të madhe sepse ato ndihmojnë në nivel komunal si dhe në nivel të buxhetit të shtetit ku shfrytëzimi i koncesioneve mundëson zhvillimin e sektorit real ekonomik si dhe zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme ekonomike. Duke parë faktin që R.Maqedonisë posedon burime minerale dhe paraqet sektorin të tret të eksportit më të madh në Maqedoni, të njihemi me procedurën dhe dhënien e koncesioneve si dhe politikën që udhëhiqjen për koncesionet do të na ofroj një pasqyrë të qartë se si mund të futemi në sektorin e minierave, se si funksion ky sektorë, përfitimet që realizojnë institucionet publike dhe subjektet private duke marrë parasysh se shumë pak jemi të njohur me këtë lëmi kjo do të na ndihmojë të njihemi më nga afër.

Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit

Hulumtimi thekson nevojën e njohjes së koncesioneve të mineraleve se si ajo ndikon në rritjen ekonomike dhe paraqet nevojën e pyetjeve hulumtuese: Dhenia e koncesioneve a është në mënyrë transparente? Cilat janë kriteriumet për marrjen e koncesioneve? Sa koncesionet minerale kontribuojnë në buxhetin e shtetit? Cilat janë përfitimet e subjekteve ekonomike gjatë marrjes së koncesioneve? Si mund të përfitojmë tenderin e koncesioneve? Sa kërkesat e koncesioneve janë objektive dhe reale? Pse rajoni i Shkupit dhe Lindor posedon më tepër koncesione? Ritja e koncesioneve a do të ndikoj pozitivisht në rritjen ekonomike?

¹ <https://www.mia.mk/Mobile/sq/Home/RenderSingleNews/301?newsID=133621284>

Për t'i dhënë përgjegje këtyre pyetjeve hulumtuese përgjegje ne do të parashtrojmë hipotezat në vijim:

- 1. Menaxhimi transparent dhe ligjor i koncesioneve minerale nga Ministria e Ekonomisë së Maqedonisë ka ndikim pozitiv në zhvillimin e sektorit të minierave dhe eksploatimeve gjeologjike në përgjithësi dhe kontribuon në rritjen e investimeve në sektorin e ndërtimit dhe zhvillimin e industrisë,**
- 2. Kriteriumet dhe kushtet e ndërlikuara që duhet të plotësojnë firmat që të marrin në posedim një koncesion mineral i marginalizojnë firmat me performancë ekonomike të vogël dhe mesatare dhe mundëson përzgjedhjen e koncesioneve vetëm kompanive me performancë të lartë ekonomike ,**
- 3. Shumica e koncesioneve minerale jepen në rajonin e Shkupit dhe Lindor ndërsa në rajonet tjera planore lejet koncesionare janë minimale me theks të veçantë në rajonet dhe komunat me popullsi shqiptare.**
- 4. Koncesionet ndikojnë në mënyrë pozitive në buxhetin e shtetit dhe në nivelin komunal.**

Për konstatimin e besueshmërisë së rezultateve ne kemi aplikuar disa qasje që përdoren në hulumtimet ekonomike. Përveç metodës kualitative si të tilla qasja narrative dhe krahasimore, gjithashtu janë përdorur disa qasje në kuadër të metodave kuantitative. Rezultatet e aritura kanë për qëllim politikat e dhënies së koncesionit në periudhën e caktuar duke u bazuar në kriteriumet e vendosur nga Ministria e Ekonomisë në dhënien e koncesioneve ku kemi përdorur një metodologji mjaftë të sofistikuar duke u bazuar në të dhënat reale dhe faktike.

Ky punim është strukturuar si vijon:

- në pjesën e parë metodologjia e hulumtimit, rendesia dhe hipotezat e hulumtimit,
- në pjesën e dytë legjislative juridike dhe procedura për dhënien e koncesioneve,
- në pjesën e tretë koncesionet në vendet e Ballkanit perëndimor,
- në pjesën e katërt analiza dhe diskutimi i rezultateve dhe
- në pjesën e fundit përfundimet dhe rekomandimet.

Legjislativa juridike dhe procedura e dhënies së koncesioneve

Koncesionet e burimeve minerale kanë një rëndësi të madhe për ekonominë dhe zhvillimin e vendit në tërësi. Republika e Maqedonisë ka pothuajse tre për qind nga e gjithë pasuria botërore e mineraleve. Vendi nuk ka burime të diamanteve, por për këtë arsye është e vetmja në botë që në territor të saj e ka minierën Alshar në malin Kozhuv, ku ka vend të pasur të një nga mineralet më të rralla, sic është loranditi.²

Qëllimi kryesor i ligjit për burimet minerale është të rregullojë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së hulumtimit gjeologjik dhe eksploatimin e burimeve minerale, inkurajimin dhe promovimin e njëjtë për të siguruar shfrytëzimin optimal të burimeve minerale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, ndërsa procedura për dhënien e koncesioneve për hulumtime gjeologjike të ardhshme, hulumtime të hollësishme gjeologjike dhe shfrytëzim të burimeve minerale, kryhet nga organi i administratës shtetërore përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e burimeve minerale.

Ligjet bazike dhe aktet nënligjore që rregullojnë procesin e dhënies së koncesioneve.

Qëllimi kryesor i ligjit për burimet minerale është të rregullojë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së hulumtimit gjeologjik dhe eksploatimin e burimeve minerale, inkurajimin dhe promovimin e njëjtë për të siguruar shfrytëzimin optimal të burimeve minerale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ligji për burimet minerale rregullohet nga:

- Kushtet dhe mënyra e kryerjes së eksplorimeve gjeologjike, promovimi dhe zhvillimin e eksplorimeve gjeologjike me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit optimal të tyre në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit,
- Promovimi dhe zhvillimi i shfrytëzimit të burimeve minerale, si dhe forcimi i masave për sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut,

² Ketii Mickovska 2017 “Mineralet e cmueshme nga mbrendësua e Republikës së Maqedonisë <https://www.mia.mk/Mobile/sq/Home/RenderSingleNews/301?newsID=133621284>

- Promovimi dhe zhvillimi i përpunimit të mineraleve, si dhe forcimi i masave për sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut,
- Mbikëqyrjen dhe kushtet për kryerjen e eksplorimeve gjeologjike, shfrytëzimin e mineraleve dhe përpunimit, dhe
- Masat dhe mënyra se si ndikimet e dëmshme në mjedis dhe në shëndetin e njeriut shkaktuar nga menaxhimi i mbeturinave që është krijuar ose është krijuar tashmë nga eksplorimet, shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve është parandaluar ose reduktuar në masën më të ulët të mundshme.³

Procedurat e përcaktuara me këtë ligj do të zbatohet Ligji për koncesione dhe partneritet privat publik, Ligjin për procedurën administrative, Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe Ligjin e mjedisit, përveç kur me ligj nuk është e rregulluar ndryshe.

Procedura për dhënien e koncesioneve për hulumtime gjeologjike të ardhshme, të detajuara gjeologjike dhe shfrytëzim të burimeve minerare, kryhet nga Ministria e Ekonomisë-Departamenti i burimeve minerare, Koncesioni për kërkimet gjeologjike-eksplorimet mund të jepet për çdo person juridik, përfshirë personat juridikë të huaj që kanë një zyrë degë të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër. Ku koncesioni për hulumtime gjeologjike jepet:⁴

Koncesioni i Kërkimit Gjeologjik themelor

- ❖ Eksplorimet bazike gjeologjike janë veprimtari me interes publik.
- ❖ Eksplorimet bazike gjeologjike duhet të sigurojnë të dhëna bazike gjeologjike që përdoren për shfrytëzimin e depozitave minerale, furnizimin me ujë, objektet hidroteknike dhe infrastrukturore, bujqësinë, si dhe për qëllime të planifikimit hapësinor.
- ❖ Eksplorimet bazike gjeologjike zhvillohen nga Instituti i Gjeologjisë së R.M.

Koncesioni i kërkimit Gjeologjik shkencor

- ❖ Është dy vjet, për personat fizikë dhe katër vjet, për personat juridikë që veprojnë në fushën e shkencave gjeologjike.
- ❖ Zona e koncesionit për kryerjen e eksplorimeve gjeologjike për prospektim, më së shumti do të arrijnë 5.000 km²

³ 1Ligji për Minerale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2012, 25/2013, 93/2013, 44/2014, 160/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 120/2016 dhe 189/2016).

⁴ ЗАКОН ЗА КОНЦЕСИИ И ЈАВНО ПРИВАТНО ПАРТНЕРСТВО (RM-NR 120/2016)

- ❖ Zona e planifikuara për eksplorime gjeologjike shkencore të përcaktuara nga koordinatat në hartën gjeologjike në një shkallë prej 1: 100.000 ose 1: 200.000
- ❖ Procedura për dhënien e koncesionit për kërkimet gjeologjike eksplorimet do të fillojë duke paraqitur një nismë-iniciativë deri te organii administratës shtetërore kompetent për aktivitetet në fushën e mineraleve.
- ❖ E drejta për të kryer eksplorimet gjeologjike do të fitohet duke konkuruar për një koncesion për eksplorim gjeologjik që është dhënë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të një thirrje publike nga një ankand elektronik nën kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe Ligjin për koncesione dhe partneritetin publiko privat.
- ❖ Në bazë të vendimit për dhënien e koncesionit për kërkimet gjeologjike-eksplorimet, dhënësi i koncesionit dhe koncesionari do të përfundojnë me një marrëveshje për koncesion për kërkimet gjeologjike-eksplorimet.
- ❖ Zotëruesi i një koncesioni për kërkimin e eksplorimeve gjeologjike, gjatë eksplorimeve gjeologjike, është i detyruar të paraqesë një projekt për kryerjen e hulumtimeve kërkimore gjeologjike - të kryejë aktivitetet në përputhje me projektin.

Koncesioni i Eksplorimeve gjeologjike të detajuara minerale

- ❖ eksplorimet hollësishme gjeologjike do të zhvillohet në një zonë ku ekzistenca e një dhe shumë minerale është përcaktuar me qëllim të gjetjes së të dhënave për pozitën, formë, krijimin, cilësia e depozitave, rezervat, kushteve dhe mundësive për përdorim të tyre
- ❖ Zona ku jepet koncesioni për eksplorime të detajuara gjeologjike do të varet nga lloji i mineraleve, domethënë:-

30 km² për mineralet e energjetike,

- 30 km² për mineralet metalike,

- 30 km² për mineralet teknogjene,

- 2 km² për mineralet jo metalike,

- 5 km² për gurin arqitektonik, dhe

- 2 km² për ujërat minerale, termo-minerale, termale dhe ujërat minerale dhe gazin CO₂.

- ❖ Periudha për të cilën jepet koncesioni për eksplorime të detajuara gjeologjike varet nga lloji i mineraleve dhe do të arrijë në:

- gjashtë vjet për mineralet e energjetike;

- gjashtë vite për mineralet metalike;

- tre vjet për mineralet e teknologjisë;
- dy vjet për mineralet jo metalike;
- dy vjet për gurin arqitektonik, dhe
- dy vjet për mineralet, termo-mineralet, ujërat termale dhe ujërat minerale dhe gazit CO₂
- Procedura për dhënien e koncesionit për eksplorime të detajuara gjeologjike fillon me dorëzimin e nismës tek organi i administratës shtetërore përgjegjës për veprimtaritë në fushën e mineraleve.

KONCESION PËR SHFRYTËZIM TË MINERALEVE

- Shfrytëzimi i burimeve minerare është marrë me marrjen e një koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerare, të cilat jepen nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë
- Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerare jepet për një vendndodhje të përcaktuar të përcaktuar me koordinatat e vendosura në hartë topografike të bazuar në elaboratin nga hulumtimi i detajuar gjeologjik i kryer.
- Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerale jepet për një periudhë deri në 30 vjet me mundësi për zgjatje për një periudhë tjetër, dmth. deri në shfrytëzimin e plotë të burimeve minerale për të cilat është dhënë koncesioni, por jo më shumë se 30 vjet .
- Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerare jepet në bazë të një thirrjeje publike kur pronari i rezultateve të eksplorimeve të detajuara gjeologjike të kryera është Republika e Maqedonisë.
- Thirrja publike zbatohet në një mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe Ligjin për koncesione dhe partneritetit publiko privat.
- Dhënia e koncesionit për shfrytëzimin e burimeve minerale bëhet me kërkesë të personit të interesuar
- Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerare jepet në bazë të kërkesës së personit që ka kryer eksplorime të detajuara gjeologjike dhe kur rezultatet e eksplorimeve të detajuara gjeologjike të kryera janë pronë e tij.
- Kërkesa i dërgohet organit të administratës shtetërore përgjegjëse për kryerjen e punëve në fushën e resurseve minerale në një periudhë prej 120 ditësh, e llogaritur nga dita e skadimit të koncesionit për kërkime detale gjeologjike.⁵

⁵Ligji për Minerale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" ligji nr 1, Neni 10-35,136/2012)

Burimet kryesore dhe ndarja e lëndëve minerale në RM

Resurset natyrore janë të mira materiale, të cilat i ofron natyra për përdorim në forma të ndryshme, ndërsa potenciali natyror paraqet burimet dhe rezervat natyrore të cilat mund të përdoren në gjendje natyrore apo pas përpunimit, duke krijuar vlerë ekonomike. Varësisht nga kushtet e formimit të tyre, burimet natyrore mund të klasifikohen në bazë të origjinës së burimit të tyre, psh, nga atmosfera (era, shiu, rrezatimi diellor), Litosfera (mineralet dhe toka), hidrosfera (ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë), Biosfera (flora dhe fauna). Sipas formimit, burimet natyrore mund të jenë të ripërtitëshme (Dielli, era, uji etj). ndërsa burimet jo të ripërtitëshme janë (mineralet, qymyri, nafta, gazi natyrorë etj). Përdorimi i cilit do nga këto burime duhet të jetë racional sidomos përdorimi i burimeve minerale ngase shkakton ndotje mjedisore dhe degradim të tokës, por edhe për shkak të rëndësisë strategjike të tyre për vendin dhe politikave ekonomike. Burimet minerale janë të mira materiale, të cilat, në një fazë të caktuar të zhvillimit të teknologjisë mund të përdoren ekonomikisht në gjendjen e tyre natyrore ose pas përpunimit. Mineralet kanë përfaqësim të kufizuar në korën e tokës në të cilën përmbajtja e ndonjërit mund të jetë shumë më e madhe në raport me disa tjera që janë shumë të rralla nga përmbajtja e tyre mesatare, prandaj duhet të shfrytëzohen në mënyrë racionale. Vendet dhe popujt të cilat i posedojnë këto begati natyrore, konsiderohen si vende me potencial për zhvillim ekonomik, njëherë paraqesin begati dhe mirëqenie shoqërore, por kjo mund të sjell edhe fatkeqësi, për shkak të interesave të vendeve të cilat nuk i posedojnë.⁶

Mineralet janë të gjitha substancat minerale organike dhe inorganike që gjenden në një gjendje të ngurtë, të lëngshme ose të gazit; materialet e para minerale të përfituara nga depozitat e mineraleve janë aplikuar pothuajse në të gjitha degët e industrisë, vendi i banimit ka rëndësi industriale nëse mund të përdoret ekonomikisht në mënyra të ndryshme. Sipas përbërjes, depozitat janë të ndara në metalike jo-metalike dhe minerale. Rezervat minerale përcaktohen me sasinë e substancës së veçantë minerale në depozitë përcaktuar nga raporti i detajuar i eksplorimeve të detajuara gjeologjike të kryera ndërsa eksplorimet gjeologjike janë një sërë metodash dhe teknikash që synojnë mbledhjen e informacionit bazë për të cilën është përcaktuar struktura gjeologjike e një zone të caktuar të Tokës.⁷

⁶ Resurset minerale si potencial për zhvillimin ekonomik:publikimi,2015
https://www.researchgate.net/publication/311811271_RESURSET_MINERALE_SI_POTENCIAL_PER_ZHVILLIM_EKO_NOMIK

⁷ **Jane Jakimovski** 2015, Zhvillimi I sektorit minerar në R.Maqedonisë burimi:
<http://www.lawyerissue.com/the-developing-mining-sector-in-the-republic-of-macedonia/>

Minieralet është një përzierje e materieve minerale dhe minerale me ngjyra nga të cilat mund të prodhojë një koncentrat metalik një herë. Minierat të ndara në metale dhe jo-metalike, në praninë e të cilave mineralet janë më të pranishme në to.⁸

depozitat metalike ose minierat përmbajnë minerale që mund të prodhojnë disa metale (hekur, mangan, nikel, krom, plumb, zink, bakër, Wolfram, kallaj, platinum, molibden, antinom, talium, arsen, merkur, argjend, ari, dhe lloje të tjera të metaleve që mund të shfaqen gjatë eksploatimit). Një shumëllojshmëri e mineraleve përmbajnë një sërë mineralesh jo metalike në formë të karbonateve, silikate ose sulfateve.

depozitat jo metalike përmbajnë një ose më shumë minerale që mund të përdoren teknikisht ose ekonomikisht (gur gëlqeror - kalcite, gur gëlqeror - dollomite, kuarç, kuartzite, rërë kuarç, diabaz, feldspat, mikë, disten, tokë diatomike, talk, breccias opal, basalt, grafit, perlite, shtuf, allçie, tokë, sulfur, barite, karbonat magneziumi, fluori, asbest, tulla dhe argjila qeramike,).

caustobiolites (ligatinat minerale) në të cilat shfaqen të gjitha llojet e qymyrit (antracit, llaç guri), nafta dhe tokës.

- **mineraleve energjetike:** të gjitha llojet e karbonit fosile, karbonit në një gjendje të lëngshme dhe të gazit, gjendje të ngurtë, elementet radioaktive (uraniumit dhe toriumit), të gjitha llojet e bituminoze dhe naftës argjilor dhe shkëmbinj, dhe gazrave të tjera që janë gjetur në tokë

- **mineraleve teknogjene:** mineralet e krijuara në procesin e energjisë dhe përpunimit metalike minerale, duke përfshirë mbetjet nxjerrëse krijuar në rrjedhën e shfrytëzimit dhe përpunimit të gurit arkitektonik,

- **guri arkitektonik:** mermer, granit, gabro, travertine, Onyx, basalt, cianite, breccias, etj,

- **ujë mineral,** termo-mineral, ujërat termale dhe ujërat minerale dhe gazi CO₂, dhe

- **rërës dhe zhavorrit** që gjenden në shtretërit dhe mbi sipërfaqen e trupave ujorë sipërfaqësorë (rrjedha e ujit, liqeneve dhe akumulimeve), dhe agregat kuarç.⁹



⁸ Qendra për komunikime civile 2016: Klasifikimi i burimeve minerale në RM <http://prizma.mk/baza-na-podatotsi-kontsesii-na-mineralni-surovini/>

⁹ Ligji për mineralet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 136/2012, 25/2013, 93/2013, 44/2014, 160/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 120/2016 dhe 189/2016). Neni 1-10

Gjatë analizës së ketij hulumtimit se si kanë qenë burimet minerale te koncesionet gjatë periudhës 2008-2017 e kemi paraqitur në menyre tabelare ku mund të shohim koncentrimin më të madh të burimeve minerale,dhe gjendjen e tyre gjatë kesaj periudhe në km2 dhe tariffën e e shfrytëzimit të sipërfaqes në km2.

	2008			2017		
	Vlera ne km2	Vlera tarifore km2	%	Vlera ne km2	Vlera tarifore km2	%
gur gelqeror	25.408	7,527,142.00	8.14%	34.21	29,444,478.00	9.80%
GAZ CO2	5.7	3,257,591.00	1.83%	5.7	4,113,010.00	1.60%
Kuarc	13.369	229,474.00	4.28%	17.74	2,350,080.00	5.10%
ujra nëntokësore	1.946	1,444,339.00	0.62%	2.03	1,951,413.00	0.60%
Argjile	7.792	1,052,391.00	2.50%	4.57	936,394.00	1.30%
zink,baker	80.15	30,048,887.00	25.69%	104.28	34,796,621.00	30.02%
uje termal	4.7045	2,298,792.00	1.51%	8.11	7.00	2.30%
Mermer	50.387	21,885,017.00	16.15%	40.81	50,330,908.00	11.70%
rere,zhavor	9.856	5,995,116.00	3.16%	2.23	6,313,285.00	0.60%
diabaz dolomite	13.537	2,179,879.00	4.34%	10.14	3,613,094.00	2.90%
ujrat mineral	17.985	947,870.00	5.76%	10.38	8,121,300.00	3.01%
Granit	21.0854	854,910.00	11.87%	7.41	2,514,460.00	4.10%
Gips	2.098	2,657,920.00	1.18%	3.66	2,752,439.00	2.00%
Thengjill	34.016	49,475,808.00	19.15%	33.1	45,803,727.00	18.50%
te tjerat	23.965	8,900,654.00	13.49%	63.2	119,703,318.00	35.30%
Totali	312	138,755,790.00	100%	347.57	246,152.73	100.00%

Tabela1.Të dhënat e pjesmarjes së burimeve minerale 2008-2017

¹⁰


Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga të dhënat vërejm se kemi pjesmarje më të lartë të burimeve metalike kryesisht Pbumb-Bakër dhe zink, ku më pastaj vjen burimet jometalike kryesisht vend të rëmdësishëm zën në sektorin e ndërtimtarisë,pastaj vejn guri arkitektonik. Ku nga kjo tabele mund të vërejm se burimet minerale më të koncestuara kemi te guri gelqeror me 8.14% që rritet në 9.80%,mermeri me 16.15% në vitet e ardhshme kemi zvoglim dhe pjesmarja e saj arrinë ne 11.70%, thëngjilli 19.15% ku pothuajse gjatë gjithë periudhës së analizes kemi pjesmarje të njejtë në 18.50%,ndersa një përqindje më të madhe shohim te burimet minerale metalike kryesisht zink baker e cila është mbi 30 %.

¹⁰ Raportet vjetore të Pagesave të Koncesionerëve (2008-2017), (Regjistri Qendror i RM)

Ndërsa se si ka lëvizur pjesmarja e burimeve minerale nga viti 2008-2017 e kemi paraqitur në mënyrë grafike ku shohim edhe pjesmarjen e burimeve më të rëndësishëm në RM, dhe të ardhurat që ato I realizojnë në periudhën konkrete, ku depozitat metalike zënë vend të rëndësishëm në ekonominë e vendit ku pjesa më e madhe eksportohet dhe zënë kontribut që sektori i minierave të bëhet sektori III i eksportit më të rëndësishëm në vend dhe të ndikojë në mënyrë positive në zhvillimin e mineraleve.¹¹

Grafikoni 1. Të dhënat e pjesmarjes së burimeve minerale 2008-2017



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Mënyra e pagesës dhe niveli i tarifave të koncesioneve minerale

Qeveria me propozim të ministrit udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e aktiviteteve në fushën e mineraleve i cili do të miratojë një listë të çmimeve në përcaktimin e shumës së tarifave për lëshimin e lejeve, koncesioneve për hulumtime të hollësishme gjeologjike dhe koncesioneve për shfrytëzimin e mineraleve, në varësi të llojit, sasisë, cilësisë dhe mënyrës së përpunimit të mineralit.

Në pajtim me Ligjin për resurset minerale, paguhen këto ndihma:

¹¹ Gligor Jovanovski, Blažo Boev and Petre Makreski 2013 “ Minerals from the Republic of Macedonia with an introduction to mineralogy” Botimi VII, f 83-94 file:///C:/Users/User/Downloads/197-3094-1-PB%20.pdf

- ❖ Pagesa për koncesion të hulumtimeve gjeologjike të detajuara
- ❖ Pagesa për koncesion për shfrytëzimin e burimeve minerale
- ❖ -Fondet e ndihmës për kryerjen e eksploatimit dhe shfrytëzimin e burimeve minerare në shumën prej:

- 22% janë të hyra nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe
- 78% janë të ardhurat e buxhetit të komunës në territorin e së cilës kryhet veprimtaria koncesionare.

Mjetet në vlerë prej 4% që janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë do të përdoren për rekultivim dhe të kthehet në gjendje të dobishme zonat të degraduara ku eksplorimet gjeologjike ose shfrytëzimi i mineraleve janë kryer. Kur aktiviteti i lidhur i koncesionit është kryer në një territorin e disa komunave, fondet e komunës, do të shpërndahen në mënyrë proporcionale të komunave në varësi të madhësisë së zonës për të cilën koncesion është dhënë. Gjatë kryerjes së një procedure për dhënien e koncesioneve për eksploatimin e mineraleve me anë të një thirrje publike, duke filluar nga çmimi minimal që përcaktohet nga koncensiondhënësi, koncesionit do të konsiderohet shuma e tarifave për përdorimin e zonës për të cilën dhënien e një koncesioni për shfrytëzimin e mineraleve propozohet nga lista e çmimeve të vendosura. Qeveria mund të përcaktojë një çmim më të lartë ose më të ulët minimale në varësi të vendndodhjes dhe llojin mineral ku gjatë kryerjes së një procedurë për dhënien e koncesioneve për hulumtime të hollësishme gjeologjike ose eksploatimit të mineraleve me anë të një thirrje publike, ofertuesit duhet të paraqesë një garanci për pjesëmarrje në procedurën e cila nuk mund të jetë më pak se 10% e vlerës së përcaktuar në ofertën.¹²

Koncesionari për hulumtime të hollësishme gjeologjike të lëndëve të para minerale paguan shumën, në përputhje me çmimin e ofruar në oferten e thirrjes publike

Koncesionari që kryen hulumtime të hollësishme gjeologjike të mineraleve do të paguajnë tarifë për përdorimin e zonës, në varësi të llojit të një minerali të përcaktuar në kontratë, për kryerjen e hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Koncesionari që shfrytëzon mineralet do të jetë i detyruar të paguajë:

- ❖ një tarifë vjetore për shfrytëzimin e sipërfaqes së dhënë nga koncesioni i shfrytëzimit, në varësi të llojit të mineralit që është objekt i koncesionit të shfrytëzimit dhe
- ❖ një tarifë për shumën e mineralit të shfrytëzuar, subjekt i koncesionit

¹² PROCEDURA PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE PËR KËRKIME GJEOLGJIKE TË PËRFSHIRË, HULUMTIMET E DETAJUARA GJEOLGJIKE DHE SHFRTËZIMET E BURIMEVE MINERALE(RM-NR.3-7/2015)

Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën e koncesionit për shfrytëzimin e zonës për të cilën është dhënë koncesioni për eksplotimin e mineraleve për secilin vit veç e veç, më së voni deri në 31 dhjetor në vitin aktual. Paga e tarifave koncesionit për sasinë e shfrytëzuar të mineraleve do të bëhet çdo tre muaj për sasinë e shitura të mineraleve nga koncesionari. Koncesionerët janë të detyruar të paguajnë këto tarifa 15 ditë në muajin vijues pas skadimit të tre muajve që përdoren si bazë për llogaritjen.

Për lëshimin e licencave dhe koncesioneve për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike paguhet:

1. Kompensimi në vlerë prej 120.000, 00 denarë për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike të burimeve minerale të energjetike,
2. Kompensimi në vlerë prej 120.000, 00 denarë për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike të burimeve minerale metalike;
3. Kompensimi në vlerë prej 60.000,00 denarë për gurë arkitektonik, , gurit ndërtimor-teknik, rërës , zhavorrit, argjilës për tulla, si dhe mineralit të mbetur jometal;
4. Kompensimi në shumën prej 60.000, 00 denarë për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike të ujërave minerale dhe nëntokësore.

Lista tarifore për burimet minerale:

A. Burimet minerale të energjisë:

1. Për shfrytëzimin sipërfaqësor ose nëntokësor të thëngjillit në vlerë prej 240.000, 00 denarë / km²;
2. Për shfrytëzimin e ujit gjeotermik në vlerë prej 200.000, 00 denarë / km²;
3. shfrytëzimin e dioksidit të karbonit (CO₂), si dhe gazrave të tjera në sasinë e 120.000, 00 denarë / km²;
4. shfrytëzimin e hidrogjenit të karbonit në të ngurtë, të lëngshme dhe / ose gjendjen e gazit në sasinë e 240.000,00 denarë / km²;
5. Për shfrytëzim sipërfaqësor dhe shfrytëzim nëntokësor të gjitha llojeve të bitumit dhe shkëmbinj me yndyrë në shumën prej 240.000, 00 denarë / km².

Ndërsa për shfrytëzimin e burimeve minerale sipërfaqësor të qymyrit në vlerë prej 1.5% të vlerës së burimit mineral të përcaktuar në shumën prej 600,00 denarë për ton të thëngjillit (Den / t); ndërsa për shfrytëzimin e burimeve minerale nëntokësore paguan 0.75% të vlerës, 600,00 denarë për ton të thëngjillit (Den / t)

B. Burimet minerale metalike:

- Për shfrytëzim sipërfaqësor dhe shfrytëzimin nëntokësor të burimeve minerale metalike në shumën prej 180.000, 00 denarë / km² paguhet tarifa vjetore deri 31.12 të vitit kalendarik në vijim
- ndërsa për shfrytëzimin për mineralet metalike, tarifa është 2% e vlerës së tregut të metalit në berze të Londrës për metale tre muajt e fundit .

C. Burimet minerale teknogjene:

- Për sipërfaqe dhe shfrytëzimin nëntokësor të burimeve minerale teknogjene në shumën prej 180.000, 00 denarë / km². paguhet tarifa vjetore deri 31.12 të vitit kalendarik në vijim

D. Burimet minerale jo metalike:

1. për sipërfaqen dhe / ose shfrytëzim nëntokësor grafit, sulphyre, magnezite, phylorite, barite, asbest, liscune, fosfate, gipsi, calcite, gelqere, argjila bentonite, kuarc, rërë kuarc, caoline, argjila qeramike dhe zjarrit-rezistente, pheldspat , talk, shtuf, lëndëve të para për prodhimin e çimentos dhe gëlqeres dhe karbonateve dhe silikate lëndëve të para për përpunim industrial në vlerë prej 100.000, 00 denarë / km²;
 2. Për sipërfaqe dhe shfrytëzimi nëntokësor prej guri arkitektonike-ndërtimor (mermer, granit, oniks, travertin dhe të ngjashme) në vlerë prej 100.000, 00 denarë / km²;
 3. për sipërfaqe dhe shfrytëzimin nëntokësor të gurëve të çmuar në vlerë prej 100.000, 00 denarë / km²;
 4. për sipërfaqe dhe shfrytëzimin nëntokësor të gurit ndërtimor-teknik, rërë ndërtimit, zhavorr dhe argjile për tullat, si dhe të gjitha burimet e mbetura minerale në vlerë prej 100.000, 00 denarë / km².
- Ndërsa për shfrytëzimin për mineralet jo-metalike, tarifa është 3% e vlerës së tregut të burimeve minerale.

E. Ujërat si:

- Për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore për të pirë në vlerë prej 120.000, 00 denarë / km².
- ndërsa për shfrytëzimin e mineraleve dhe ujë nëntokësor për të pijshëm në vlerë prej 3% të vlerës së burimeve minerale të përcaktuara në vlerë prej 4,00 denarë për litër (Den / l);

Për gurët e dekorimit, tarifa e koncesionit varet nga lloji:

- marmal 15 € për metër kub;

- graniti 9 € për metër kub;
- oniks, travertin € 6,5 për metër kub.

□ Për mineralet për industrinë e ndërtimit, tarifa është 0.15 euro për ton.¹³

Dokumentacioni, procedura e konkurimit dhe zgjedhje e kompanive fituese

Për të filluar procedurën për dhënien e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm dhe marrëveshjes mbi themelimin e partneritetit publik-privat, dhënësit ose partneri publik merr vendimin për fillimin e procedurës për ndarjen e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm ose të kontratës për krijimin e një partneriteti public-privat.

Vendimi për të filluar një procedurë për dhënien e një koncesioni për mallrat me interes të përgjithshëm permbanë:

- ❖ shpjegimi i justifikimit për dhënien e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm - caktimin e qëllimeve të saj,
- ❖ objekt i koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm
- ❖ mënyrën dhe afatin kohor brenda të cilit do të kryhet procedura;
- ❖ shumën e taksës për lëshimin e dokumentacionit të tenderit.

Dokumentacioni i tenderimit

Komisioni është i detyruar të përgatisë dokumentacionin e tenderit brenda afatit të përcaktuar me vendim për fillimin e procedurës për dhënien e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm. Komisioni mund t'ia besojë përgatitjen e dokumentacionit të tenderit një organizate shkencore ose profesionale ose ekspertë në fushën përkatëse. Komisioni mund të përcaktojë që të dhënat ose një pjesë e të dhënave të përmbajtura në dokumentacionin e tenderit konsiderohen konfidencialë në pajtim me Ligjin për Informacionin e Klasifikuar. Në një rast të tillë, pjesëmarrësit në procedurë janë të detyruar të paraqesin një deklaratë bashkëngjitur dokumentacionit që i detyron ata të mos publikojnë të dhënat që konsiderohen konfidenciale.

Në varësi të natyrës së koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm, dokumentacioni i tenderit në veçanti përmban elementet e mëposhtme:

¹³ të Ligjit për burime minerale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", No.136 / 12, 25/13, 93/13 dhe 44/14), LISTA E TARIFAVE

- ❖ emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe e-mail i dhuruesit,
- ❖ subjekt i koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm,
- ❖ qëllimi i koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm,
- ❖ vendndodhjen dhe vendin ku do të jepet koncesioni i mallrave me interes të përgjithshëm,
- ❖ udhëzime në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës,
- ❖ periudha për të cilën jepet koncesioni i mallrave me interes të përgjithshëm,
- ❖ Afati i fundit për dorëzimin e ofertave,
- ❖ Afati i vlefshmërisë së ofertës,
- ❖ adresa në të cilën dorëzohen ofertat,
- ❖ llojet e garancive dhe kushtet e garancive,
- ❖ gjuha në të cilën duhet të shkruhen ofertat,
- ❖ kushtet personale, profesionale dhe financiare që duhet të përmbushen nga ofertuesit dhe dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e tyre,
- ❖ kriteret sipas të cilave është bërë përzgjedhja e ofertës më të favorshme,
- ❖ emrin dhe adresën e autoritetit kompetent për zgjidhjen e ankesave dhe afatet për parashtrimin e ankesave,
- ❖ shumën minimale të tarifës së koncesionit, nëse është siguruar dhe / ose mënyrën e llogaritjes së kompensimit;
- ❖ informacione të tjera relevante në lidhje me subjektin e koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm në përputhje me rregulloret dhe rregullat e tjera profesionale.

Pjesëmarrja në procedurën për dorëzimin e ofertave është i kushtëzuar me garanci nga ofertuesi në formën e një depozite apo garancie bankare me një vlerë që duhet të jetë të paktën 0.25% të vlerës së vlerësuar të përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Konkensiondhënësi, brenda shtatë ditëve pas nënshkrimit të kontratës për koncesion për mallrat e interesit të përgjithshëm me ofertuesin më të mirë, ofertuesit e tjerë që morën pjesë në koncesion të kthejë shumën e depozituar, apo garanci të pjesëmarrjes në procedurë.

Procedura e dhënies së koncesionit

Koncesioni për hulumtime gjeologjike të detajuara jepen në bazë të një thirrjeje publike me ankand elektronik, me përjashtim të kompanive publike, institucioneve publike, si dhe subjekteve që janë pronarë të tokës ku koncesioni kërkohet për burimet minerale si rëra apo kuarc kolektiv, ku koncesioni jepet në bazë të kërkesës.

Procedura për dhënien e **koncesionit për hulumtime të detajuara gjeologjike** fillon me paraqitjen e një iniciative për dhënien e koncesionit për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike. Iniciativa mund të dorëzohet nga secili person juridik i interesuar, duke përfshirë personat juridikë të huaj me zyrë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, përveç të cilave ata janë të obliguar të dorëzojnë:

- ❖ Shpjegimi dhe të dhënat bazë për paraqitësin e iniciativës;
- ❖ Periudha e propozuar gjatë së cilës do të jepet koncesioni;
- ❖ Vendndodhja në të cilën do të kryhen hulumtimet e detajuara gjeologjike të hartuara në hartën topografike në raport 1:25 000 ose 1: 50 000.
- ❖ një studim për vlerësimin e ndikimit dhe regjimit të mineralit, termo-minerale dhe ujrat termale në rast të një iniciative për dhënien e koncesionit për hulumtime të hollësishme gjeologjike të mineraleve, termo-minerale, ujërave termale dhe ujërat minerale dhe të gazit CO₂.

Pas dorëzimit të iniciativës, bëhet vendim për vendosjen dhe përshtatjen e hapësirës, në të cilën brenda 14 ditësh dhe pas kërkesës zyrtare kërkohet nga njësi e administratës vendore dhe organet e administratës shtetërore për kryerjen e punimeve nga sfera e mjedisit dhe hapësirës planifikimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, transportin dhe lidhjet, pylltarinë, menaxhimin e ujit dhe bujqësinë. Ministria e Ekonomisë, pas përshtatjes së lokacioneve sipas iniciativave, i paraqet Qeverisë një propozim për shpalljen e një thirrjeje publike për dhënien e koncesioneve për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike. Çdo person juridik vendas ose i huaj ka të drejtë të regjistrohet në sistemin e koncesioneve të Ministrisë së Ekonomisë. Komisioni do të bëjë një vlerësim të plotë të aftësisë së ofertuesve dhe ofertës origjinale të paraqitur në procedurën për dhënien e koncesionit për eksplorime të detajuara gjeologjike, ku ofertuesit duhet të këto dokumente:

- ❖ një dokument për një aktivitet të regjistruar të biznesit,
- ❖ një deklaratë nga ofertuesi se nuk është shqiptuar një aktvendim efektiv në lidhje me pjesëmarrjen në organizimin kriminal, korrupsionin, mashtrimin apo pastrimin e parave në pesë vitet e fundit,
- ❖ një vërtetim se procedura e falimentimit nuk është iniciuar nga një organ kompetent,
- ❖ një vërtetim që një procedurë likuidimi nuk është iniciuar nga një organ kompetent,
- ❖ një certifikatë që nuk vendos një sanksion efektiv kundërvajtës mbi praktikën profesionale, kryerjen e një veprimtarie ose detyre, përkatësisht një urdhëresë për të kryer një aktivitet të caktuar,
- ❖ një certifikatë të taksave dhe kontributeve të paguara,

- ❖ një vërtetim se nuk vendos një dënim efektiv për një vepër penale, dhe
- ❖ raporte pozitive financiare, për vitin e kaluar

Pas kryerjes së procedurës dhe vlerësimit të ofertave për dhënien e koncesioneve për kryerjen e hulumtimeve për prospektim të burimeve minerale Komisioni raporton Qeverisë për vlerësimin e ofertave më të mira, Raporti i procedurës së zhvilluar dhe projekt-vendimeve individuale për dhënien e koncesioneve në të cilën pas miratimit të tyre nga Qeveria, koncesionarët e përzgjedhur janë të obliguar që në afatin e caktuar të paguajnë kompensimin e koncesionit të ofruar në ofertë. Pas pagesës do të përfundojnë marrëveshjen e koncesionit për hulumtime për prospektim të hollësishme gjeologjike të lëndëve minerale (nënshkrues në emër të koncensiondhënësit është Ministria e Ekonomisë). Koncesionari mund të fillojë hulumtimet gjeologjike të detajuara nëse, brenda 15 ditëve para fillimit të të njëjtës, ai i paraqitet Ministrisë së Ekonomisë:

- Projekti i rishikuar për kryerjen e hulumtimeve të detajuara gjeologjike.

Procedura për dhënien e **koncesionit për hulumtime gjeologjike për prospektim** është e njëjtë me procedurën për dhënien e koncesionit për per prospektim të Koncesioni për hulumtime gjeologjike të ardhshme të burimeve minerale jepet për një periudhë prej dy vjetësh për një hapësirë maksimale prej 5000 km². Koncesionari mund të fillojë hulumtime gjeologjike nëse, pas nënshkrimit të kontratës për hulumtime gjeologjike, ai paraqet në Ministrinë e ekonomisë Projekt për kryerjen e hulumtimeve gjeologjike të reviduar nga komisioni i formuar nga Instituti gjeologjik i Maqedonise :

- Projekti i rishikuar për kryerjen e hulumtimeve gjeologjike

Pas përfundimit me hulumtime gjeologjike ardhshëm, koncesionari është i detyruar të dorëzojë në Ministrinë e ekonomisë një projekt të rishikuar për hulumtime për prospektim gjeologjike. Rezultatet e hulumtimeve të ardhshëm nuk mund të transferohet te një person tjetër dhe ata mbeten në posedim të koncesionerit deri në një kërkesë tjetër për dhënien e koncesionit për hulumtime të hollësishme gjeologjike që është aplikuar nga koncesionari. Një kërkesë mund të aplikohet për një maksimum prej 2.5% të territorit në të cilin është bërë hulumtimi gjeologjik. Pjesa tjetër e rezultateve mbetet në pronën shtetërore. Kërkesa nga ana e koncesionerit mund të zbatohet brenda 30 ditëve pas skadimit të Marrëveshjes së Koncesionit.

Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerale jepet për një vendndodhje të përcaktuar, të nga koordinatat e vendosura në një hartë topografike të elaboruar nga hulumtimi i detajuar gjeologjik i kryer. Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerale jepet për një periudhë deri në 30 vjet me mundësi për zgjatje për një periudhë tjetër, dmth. deri në shfrytëzimin e plotë të burimeve minerale për të cilat është

dhënë koncesioni, por jo më shumë se 30 vjet. Koncesioni për shfrytëzimin e burimeve minerare jepet në bazë të një thirrjeje publike kur pronari i rezultateve të eksplorimeve të detajuara gjeologjike të kryera është Republika e Maqedonisë.

Vlerësimi i ofertave më të mira

Marrja e një koncesioni për mallrat me interes të përgjithshëm bëhet përmes një thirrjeje publike. Thirrje publike për ndarjen e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm janë publikuar në "Gazetën zyrtare" të dhe mund të publikohet në gazetën brendshme dhe të jashtme dhe në faqen e internetit të dhënësit.

Oferta duhet të dorëzohet në mënyrën dhe në formën e përcaktuar me dokumentacionin e tenderit. Operatorët ekonomikë që kanë marrë dokumentacionin e tenderit kanë të drejtë të dorëzojnë ofertat. Ofertuesi mund të dorëzojë vetëm një Tender. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave të paktën 30 ditë nga data e publikimit të thirrjes publike për dhënie e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm në "Gazetën Zyrtare".¹⁴

Kriteret për përzgjedhjen e ofertave më të favorshme mund të jenë:

1) oferta më e favorshme ekonomikisht që përmban elemente që lidhen me subjektin e koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm si:

- ❖ cilësi,
- ❖ karakteristikat teknike,
- ❖ karakteristikat estetike, funksionale dhe mjedisore;
- ❖ elemente të tjera të përcaktuara në ligjin e veçantë që rregullon subjektin e koncesionit ose

2) Tarifa e koncesionit më e lartë ofruar.

Elementet e kriterit të tenderimit ekonomikisht më i favorshëm, si dhe numri maksimal i pikëve për çdo element duhet të përcaktohen qartë në thirrjen publike, e lidhur në mënyrë specifike për lëndën e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm dhe, pasi është krijuar, nuk mund të ndryshohet për tërë kohëzgjatjen e procedurës për dhënie e një kontrate koncesioni për mallrat me interes të përgjithshëm.¹⁵ Kur oferta më e favorshme është zgjedhur në bazë të kriterit Tenderimit ekonomikisht më i favorshëm, konkursiondhënësi është i detyruar për të dhënë një shpjegim për të vlerësuar dhe zbatuar elementet e

¹⁴ PROCEDURA PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE PËR KËRKIME GJEOLGJIKE TË PËRFSHIRË, HULUMTIMET E DETAJUARA GJEOLGJIKE DHE SHFRYTËZIMET E BURIMEVE MINERALE(RM-Nr.3-7/2015)

¹⁵ Thirrja publike për ndarjen e koncesioneve minerale 1/2018 <http://economy.gov.mk/doc/2333>

këtij kriteri. Çdo element i kriterit mbart një numër maksimal të pikëve që përcaktojnë thirrje publike, si dhe në raste të veçanta kur kjo nuk është e mundur, artikujt janë të shënuara në mënyrë sipas rëndësisë së tyre. Pas skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave,

Komisioni bën publikisht hapjen e ofertave në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të ofertuesve, vendin dhe kohën e specifikuar në tenderin publik për dhënien me koncesion për mallrat me interes të përgjithshëm Komisioni vlerëson ofertat vetëm për ata ofertues që përmbushin kushtet personale, profesionale dhe financiare të specifikuara në dokumentacionin e tenderit.

Komisioni do të krijojë një listë të ofertuesve në bazë të kriterëve të përcaktuara në thirrjen për ndarjen e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm ose në dokumentacionin e tenderit dhe sugjeron zgjedhjen e ofertuesit fitues për mallrat me interes të përgjithshëm . Konkensiondhënësi mund të përdorin ankandin elektronik për ofertimet pozitive si fazë e fundit në procedurën për ndarjen e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm, para dhënies së kontratës. Bazuar në propozimin e Komisionit dhe raportin e vlerësimit, dhuruesi duhet të marrë një vendim për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme. Vendimi për të zgjedhur ofertën më të mirë së bashku me një kopje të procesverbalit të inspektimit dhe vlerësimit të ofertës dhe raportit të vlerësimit i dërgohet çdo tenderues pa vonesë, në një mënyrë që dorëzimi mund të provohet. Koncesionari nuk duhet të nënshkruajë kontratën e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm para skadimit të afatit për paraqitjen e ankesës. Afati i fundit për paraqitjen e ankesës përcaktohet në vendimin për zgjedhjen e ofertës më të favorshme në përputhje me të dhënat nga thirrja publike për dhënien e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm.¹⁶

Vendimi për zgjedhjen e ofertës më të favorshme përmban:

-emrin e konkensiondhënësit me numër dhe datën e vendimit për fillimin e procedurës për dhënien e një kontrate koncesioni për mallrat me interes të përgjithshëm,

-shpjegimi i arsyeve për zgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm,

-emrin e ofertuesit me numrin dhe datën e dorëzimit të ofertës,

-subjekt i koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm,

¹⁶ ligji për koncesionet dhe partneriteti private publik (PM, 6p.06/2012)

-vendi i kryerjes së objektit të koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm,

-kohëzgjatja e kontratës së koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm,

-kushtet e veçanta të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit që tenderuesi duhet të përmbushë gjatë kohëzgjatjes së koncesionit të mallrave me interes të përgjithshëm,

-shumën e koncesionit të paguar nga koncesionari për koncesionin e dhënë për mallrat me interes të përgjithshëm ose bazën për përcaktimin e shumës së tarifës së koncesionit që duhet paguar nga koncesionari, nëse është siguruar,

-Afati në të cilin ofertuesi më i favorshëm është i detyruar të nënshkruajë marrëveshjen e koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm me koncensiondhënësin,

Koncensiondhënësi duhet të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të rregullt të zbatimit të koncesionit për mallrat me interes të përgjithshëm si dhe respektimin e detyrimeve të koncesionarit në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen me subjektin.¹⁷

1. ¹⁷ Ligji për Minerale, koncesionet dhe Partëriteti privato-Publik ("RM-nr. 136/2012, 25/2013, 93/2013, 44/2014, 160/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 120/2016 dhe 189/2016).

Koncesionet në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mal i Zi dhe Serbi) kanë rrjete të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit që nuk janë të zhvilluara sa duhet, në krahasim me mesataren e Bashkimit Evropian (BE). Mbyllja e hendekut të infrastrukturës publike do ta ndihmojë rajonin në zënien e hapit me standardet e jetesës në Evropën Perëndimore. Por nga do të sigurohen paratë? Rritja e financimit do të jetë e nevojshme si nga burimet vendore ashtu dhe ato të huaja. Planifikimi dhe realizimi më i mirë i projekteve të investimeve publike është gjithashtu i domosdoshëm, thekson një raport i kohëve të fundit. Konvergjenca e të ardhurave drejt niveleve të BE-së është ngadalësuar ndjeshëm në Ballkanin Perëndimor që nga kriza globale financiare. Zhvillimi ekonomik i rajonit po ecën ngadalë. Që vendet e rajonit ta mbyllin hendekun në standardet e jetesës me BE-në, ato do të duhet të gjejnë një mënyrë për ta riaktivizuar rritjen ekonomike.

FMN-ja ka identifikuar mungesën e infrastrukturën themelore publike në rajon si pengesë të rëndësishme për rritjen më të lartë ekonomike. Rrjetet më të mira të transportit, energjisë dhe telekomunikacionit do të ndihmonin vendet e Ballkanit Perëndimor që ta rrisin produktivitetin, të integrohen më thellë në rrjedhën e tregtisë globale dhe ta përmirësojnë atraktivitetin e rajonit për investime të huaja. Hapësira e pamjaftueshme fiskale dhe mungesa e efikasitetit në sektorin publik e bëjnë financimin privat tërheqës në investimet në infrastrukturë. Iniciativat e Partneritetit Publik-Privat (PPP) mund të jenë një opsion i mundshëm për mobilizimin e kursimet private, për të rritur efikasitetin dhe financimin në investimet publike.¹⁸

FMN sugjeron pesë elementet kyçe që një qeveri të sigurojë koncesione të suksesshme PPP janë:

- ❖ -së pari të planifikojë projekte me fizibilitet të lartë;
- ❖ -së dyti, Ministria e Financave duhet të sigurojë një kontroll të fortë dhe të mjaftueshëm në secilën fazë të projektit PPP, duke përfshirë rinegocimin e mundshëm të kontratës;
- ❖ -së treti, kornizat ligjore të kontratave duhet të jenë shumë të forta;
- ❖ -së katërti duhet të aplikohen politika të forta të buxhetimit, kontabilitetit dhe raportimit;
- ❖ -së pesti duhet bërë analiza e duhur e rrezikut fiskal në nivel projekti.

¹⁸ Raporti I fondit monetar nderkombetar 2015 Wdi,databases,eurostat,-fondi monetar nderkombetar FMN,2015

Procedura dhe praktikat e koncesioneve ne Republikën e Kosovës

Sektori minerar luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi. Synim është vlerësimi dhe kuantifikimi i përfitimeve të krijuara nga industria minerare për ekonominë e vendit në tërësi, duke marrë parasysh pengesat, kufizimet teknike, zhvillimet në tregun ndërkombëtar të resurseve minerale, si dhe karakteristikat e vendburimeve minerale. Sektori i minierave paraqet mundësi për eksport dhe për përfitime të mëdha, e sidomos në rast të privatizimit të shpejt mund të përdoret për të përkrahur ngritjen e zhvillimit ekonomik në një afat të shkurtër. Në vitet e 90-ta industria është zvogëluar si rezultat i neglizhencës dhe mungesës së investimeve kapitale.

Burimet kryesore minerare të Kosovës janë: plumbi, zinku, argjendi, nikeli, kobalt, kromi, linjiti, bakri, boksiti, magnezi, hekuri dhe disa minerale industriale si: kaolinë, bentoniti, kuarci, halloiziti, diatomite, granati, asbesti dhe leuciti. Edhe pse informatat e sakta për pasuritë nëntokësore të Kosovës nuk dihen, ato të cilat njihen e bëjnë vendin një shtet mjaft të pasur me minerale dhe pasuri të tjera nëntokësore. Vendburimet më të rëndësishme të plumbit dhe zinkut janë gjetur në pjesën verilindore të Kosovës. Ato i përkasin brezit mineralmbajtës të Pb-Zn, me gjatësi për më shumë se 80 km dhe përfshinë disa miniera.¹⁹

Ku rezervat e resurseve minerale kryesore janë:

- ✓ Linjiti: rreth 13 miliardë ton
- ✓ Plumbi dhe zinku: 59 miliardë ton
- ✓ Boksitët: 2.7 miliard ton
- ✓ Nikeli: 13 miliard ton
- ✓ Magnezi: 4.1 miliard ton

Ndërsa rezervat minerale janë vërtetuar në disa miniera si:

Tabela 2. Rezervat minerale në disa miniera

Miniera	Ton	PB%	Zn%	Ag g\ton
belo brdo	1.340.000	6.59	5.74	97.4
Crnac	1.648.000	7.57	2.93	102
Stan-Terg	432.000	5.1	2.21	805
Hajvalia	723.000	9.65	18.26	126.4
Artana-novo Brdo	2.700.000	4.43	5.42	140.6

²⁰ **Burimi:**Kalkulimi nng autori

¹⁹ Burimet minerale kryesore ne kosov Raporti 2018

https://sq.wikipedia.org/wiki/Burimet_natyrore_t%C3%AB_Kosov%C3%ABs#Burimet_e_mineraleve

²⁰ Raporti vjetor 2017-nga Ministria e zhvillimit ekonomik ,Ministria e zhvillimit ekonomik/energja/minierat,2018

Nga kjo mund të shihet qarte se kemi një pjesëmarje shumë të lartë të plumbit dhe zinkut në shumicën e minierave të Kosovës, ku më pastaj vjen linjiti poashtu edhe ai me një pjesëmarje të lartë në burimet minerale të Republikës së Kosovës si pjesë të rëndësishme depozitat metalike për zhvillimin e sektorit të minierave dhe ruajtjen dhe zhvillimin e vendit në tërësi.

Procedura për dhënien e koncesioneve minerale në Kosovë:

Personi i cili dëshiron të kryej aktivitete të hulumtimit në Kosovë duhet t'i paraqes KPMM-së një kërkesë të plotësuar për dhënien e koncesionit për hulumtim të grupit përkatës të Mineraleve brenda zonës së specifikuar. Kërkesa e tillë bëhet në formën e paraparë së bashku me pagesën e taksës së paraparë, dhe do të bashkëngjiten:

- 1.1. emrat dhe adresat e pronarëve të rëndësishëm dhe drejtorëve të aplikuesit, nëse ka të tillë;
 - 1.2. adresën zyrtare të regjistruar të aplikuesit në Kosovë;
 - 1.3. një përshkrim të aftësive teknike, profesionale dhe menaxheriale të personelit që është kryesisht përgjegjës për zbatimin e Programit të Hulumtimit, duke përfshirë edhe kopjet të CV-ve (biografive) të tyre ,
 - 1.4. një ose më shumë harta topografike
 - 1.5. përshkrim i hollësishëm i programit për hulumtim që është propozuar nga aplikuesi.
 - 1.5.1. një përshkrim të grupit të resurseve Minerale që duhet të përfshihet nga koncesioni, së bashku me të gjitha raportet gjeologjike ose të tjera ose dëshmi tjera,
 - 1.5.2. një përshkrim teknik të metodës së hulumtimit dhe pajisjeve që do të përdoren; dhe
 - 1.5.3. dokumente ose informata të tjera të cilat kërkohen me arsye nga KPMM-ja
 - 1.6. aplikuesi i ka burimet financiare që në masë të arsyeshme kërkohen për ta zbatuar programin e propozuar për hulumtim;
- Brenda tre muajve nga pranimi i kërkesës së plotë nga një aplikues i kualifikuar, KPMM-ja ose e lëshon koncesionin e kërkuar ose i dërgon aplikuesit:
- 2.1. vendimin e KPMM-së për refuzimin e lëshimit të kërkesës,
 - 2.2. një shpjegim me shkrim për arsyet e marrjes së këtij vendimi nga KPMM, dhe

2.3. një njoftim me shkrim mbi të drejtën e aplikuesit të kërkesës për ankesë dhe për t’iu drejtuar organeve gjyqësore lidhur me vendimin.²¹

Ndërsa Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale rregullon dhe i mbikëqyrë:

- ✚ Eksplorimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë;
- ✚ Shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimet e shfrytëzimit të minierave dhe zvogëlimin e ndikimit të veprimeve të shfrytëzimit të minierave në mjedis;
- ✚ Zbatimin e standardeve ndërkombëtare për veprimet në miniera dhe në gurore;
- ✚ Sigurinë gjatë veprimeve të nxjerrjes së mineraleve dhe në objektet e përpunimit në pajtim me ligjin në fuqi dhe me standardet e nevojshme për sigurinë;
- ✚ Pajtueshmërinë e përgjithshme të veprimeve për shfrytëzimin e minierave me kushtet e licencave, marrëveshjeve për leje dhe të instrumenteve të tjera për autorizim.²²

Ku KPMM jep leje, koncesione per: hulumtim,shfrytezim,leje te posacme,etj. Ndërsa në Tabela 3. kemi paraqitur se si kan qene gjatë periudhes 2012-2017


Tabela 3. Lejet e koncesioneve minerale ne Kosove

Burimi: Raporti vjetor dhe kalkulimi nga autori

lloji I koncesionit-lejes	2012	2013	2014	2015	2016	2017
koncesione per hulumtim	92	73	62	100	118	119
koncesione per shfrytezim	42	50	39	43	51	53
leje te posacme	33	47	58	59	70	70

²¹ Ligji për mineralet ne Kosovë 03-l/163,2010 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2702> (accessed on August,14, 2018)

²² Të dhënat mbi mineralet e Kosovës, Raporti Vjetor 2016-2017 nga KPMM https://www.kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2017/09/Raporti-vjetor_KPMM_2016-shq-1.pdf (accessed on August,14, 2018)



Grafikoni 2. Lejet e burimeve minerale në Kosovë 2012-2017

Burimi: Raporti Vjetor dhe kalkulimi nga Autori


Koncesioni për hulumtim të mineralet ndërtimore lëshohet në afat jo më shumë se 2 vite. Vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 50 ha. Mund të vazhdohet edhe për një periudhe kohore maksimale prej 2 viteve. Koncesioni i hulumtimit për të gjitha mineralet tjera lëshohen në afat prej jo më shumë se 3 vite. Vlen për një sipërfaqe jo më të madhe se 100 km², me mundësi vazhdimi për 2 herë, ku secili vazhdim nuk mund të jetë më i gjatë se 2 vite, pas çdo vazhdimi sipërfaqja e hulumtimit duhet të reduktohet për 50%.ku nga grafikoni mund te shohim se koncesionet per hulumtim zën një vend më të rëndësishëm. Renta minerale luan një rol të rëndësishëm për Kosovën sepse ajo paraqet nje zhvillim te sektorit ekonomik dhe finnaciari te vendit ku zhvillimi I sektorit minirar luan nje rol te rendesishem ne terheqjen e investimeve te huaja direkte. Në këtë tabel kemi paraqitur rentën minerale si ka qen e planifikuar dhe e realizuar ajo:

Tabela 4 .Renta minerale të realizuar të Republikës së Kosovës (2012-2017)

Renta minerale	e planifikuar	e Realizuar	Realizimi ne %
2017	\$ 33,000,000.00	\$ 30,570,000.00	92..63
2016	\$ 33,000,000.00	\$ 30,554,000.00	92.58
2015	\$ 26,000,000.00	\$ 29,700,000.00	114.2
2014	\$ 22,000,000.00	\$ 26,539,000.00	120.63
2013	\$ 22,000,000.00	\$ 24,693,000.00	112.24
2012	\$ 10,000,000.00	\$ 7,200,000.00	72.2

Burimi:Raportet Vjetore dhe Kalkulimi I autorit

Grafikoni 3. Renta minerale e realizuar në R. Kosovës (2012-2017)



Burimi:Raportet Vjetore dhe Kalkulimi I autorit

Rritja e të hyrave është realizuar si rezultat i rritjes së rentës minerare për linjitin, si dhe si rezultat i krijimit të një stabiliteti të shfrytëzimit të mineraleve industriale dhe atyre ndërtimore dhe instalimit apo vënies së një disipline financiare në sektorin minierar. Ku nga Grafikoni mund të shohim qarte se të hyrat më të larta të rentës minerale ka qenë gjatë vitit 2017 me 30.570.000 apo 92.63% e realizuar nga ajo që është planifikuar ku na jep një pasqyrë të qartë si një bazë që në vitet e ardhshme të kemi të ardhura më të larta nga ky sektor dhe zhvillimin e sektorit minieral.

Meqenëse mineralet janë pronë e shtetit, është shumë e qartë se qëllimi final i shtetit është maksimalizimi i përfitimit nga resurset minerare. Mirëpo, ngritja e shkallës së rentës minerare nuk do të thotë edhe maksimalizim i përfitimit, sepse nëse vendosim rentë minerare të lartë, atëherë do të kemi investime më të vogla në këtë sektor. Çdo investitor qëllimin e tij e ka profitin, prandaj është një mjeshtër i veçantë që të gjendet një optimum i shkallës së rentës minerare, me anë të së cilës do të përfitojë vetë shteti, si dhe në të njëjtën kohë të këtë investime në këtë sektor.

Procedura dhe praktika e koncesioneve në Republikën e Shqipërisë

Shqipëria është një vend i pasur me burime të mineraleve të ndryshme. Zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i tyre, përbën një aktivitet të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Tradicionalisht, mbas vitit 1944, industria nxjerrëse dhe e përpunimit të mineraleve si kromi, bakri, hekuri, qymyrguri, ka siguruar të ardhura të konsiderueshme.

Zhvillimi i industrisë minerare ka kaluar në 3 faza:

Faza e parë, përfshin periudhën e paraçlirimit, deri në vitin 1945. Kjo fazë lidhet me dy ngjarje të rëndësishme për industrinë minerare. Në vitin 1922, u përpilua Harta Gjeologjike e Shqipërisë, e para e këtij lloji në Ballkan. Në vitin 1929, u hartua dhe miratua Ligji Minerar i Mbretërisë Shqiptare, i pari në Shqipëri, mbi bazën e të cilit filloi puna për zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve.

Faza e dytë përfshin periudhën mbasçlirimit deri në vitin 1994, vit në të cilin u miratua “Ligji minerar i Shqipërisë”, me asistencën e Bankës Botërore. Në këtë fazë 1945-1994, aktiviteti minerar ishte i centralizuar, në dorën e shtetit totalitar dhe organizimi ishte në formën e ndërmarrjeve shtetërore.

Faza e tretë, përfshin periudhën mbas vitit 1944 deri në ditët e sotme. Në këtë fazë minierat u privatizuan totalisht dhe aktualisht nuk ka asnjë minierë në aktivitet, ku të jetë pronar shteti. Proçesi i liçensimit, dhënies së lejeve minerare ka filluar në fillim të fazës së tretë, në vitin 1995.

Sektori minerar përfshin një numër në rritje të kompanive të mesme dhe të vogla dhe vetëm disa kompani të mëdha industriale. Numri i përgjithshëm i licencave minerare është 640 ku 40 prej tyre janë kompani në pronësi të huaj. Sipërfaqja totale e licencuar në sektorin minerar është $S = 75,40 \text{ km}^2$. Kompanitë e mëdha të huaja në industrinë minerare janë kryesisht nga Turqia, Kanada, Kina, dhe Italia.²³

Burimet kryesore minerale janë:

kromi- Shqipëria ka prodhuar maksimalisht deri në 1.3 milionë tonë në vit. Ndërsa sot, edhe pse numri i minierave është më i madh se para viteve ‘90, vendi prodhon rreth 400 mijë tonë, pra rreth 35% të prodhimit të atëhershëm.

Bakri-Përpara viteve ‘90 vendi ynë ka prodhuar rreth 1.4 milionë tonë mineral bakri. Në total, janë zbuluar rreth 68 milionë xeherorë bakri. Në potencialin kryesor të tij e kanë vendburimet e Pukës, Mirditës, më pak të Korçës, Kukësit, Hasit dhe Shkodrës

Nikeli silikat është minerali kryesor i vendit, sepse është i vetmi mineral për të cilin Shqipëria vlerësohet me vendburime të rezervave të madhësisë së mesme, dhe veç kësaj është mjaft fitimprurës, sikur të mund të kishim të zhvilluar industrinë e përpunimit të tij. Para viteve ‘90, hekur-nikeli i prodhuar ka qenë në nivelet 1.4 milionë tonë. Ai përpunohej më tej për prodhimin e gizës dhe çelikut. Sot, problemi i tij janë kapacitetet, pasi tregu vazhdon të jetë i ulët dhe po ashtu niveli i çmimeve. Pas shkatërrimit të

²³ Agjencia e zbulimit të burimeve minerale në Shqipëri :Raporti Vjetor 2017,

<http://www.akbn.gov.al/pershkrim-i-pegjithshem-mini/>

Metalurgjikut në Elbasan, i gjithë prodhimi aktual, që shkon diku rreth 100-150 mijë tonë në vit, eksportohet i gjithi si mineral në Maqedoni e Kosovë.

Titaniumi-Është pasuria e dytë minerare. Vlerësohen të jenë rreth 130 milionë tonë rezerva, por deri më tani nuk janë nxjerrë në dritë, sepse industria e nxjerrjes dhe përpunimit të tij është shumë e kushtueshme.

Uraniumi dy janë fushat kryesore të përdorimit të këtij minerali, për prodhimin e armëve të shfarosjes në masë dhe për prodhimin e energjisë elektrike. Në vendin tonë, studimet për këtë mineral janë ende në nivelin e kërkimit, megjithatë, për aq sa është studiuar, rezervat gjeologjike të llogaritura në vendburimin e Nimçës janë rreth 29.000 tonë.²⁴

Procedura për dhënien e koncesioneve minerale në Shqipëri

- ❖ Procedura për dhënien e koncesioneve fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës ose me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës.
- ❖ Procedura për dhënien e koncesioneve minerare jepet nga Qendra Kombëtare e Licencimit, sipas procedurës së konkurrimit publik, për zonat e publikuara, sipas programit të veprimit dhe planit vjetor minerar dhe/apo shqyrtimit të plotësimit të kushteve të lejimit për zonat e hapura, sipas procedurës "I pari në kohë, i pari në të drejtë". Procedura e shqyrtimit të kërkesave për zonat e hapura, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- ❖ Kërkuesi i lejes minerare, që përfshin kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin, duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare, për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare,
- ❖ Kërkuesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare për zbatimin e programit minimal të punës, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e publikimit në gazetën zyrtare.
- ❖ Kërkuesi i lejes minerare të shfrytëzimit duhet të paraqesë dokumentin e garancisë financiare për realizimin e investimit,
- ❖ Leja minerare, që përfshin shfrytëzimin, hyn në fuqi pas plotësimit të detyrimit, dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Data e publikimit është data e hyrjes në fuqi.
- ❖ Kushtet e hollësishme të lejimit për përfitimin e lejes, dokumentet shoqëruese, afatet për vlerësimin e përmbushjes së kushteve, afati për paraqitjen e dokumenteve, që provojnë plotësimin e kushteve, organi kompetent për shqyrtimin e kushteve të lejimit e procedurat e shqyrtimit e të miratimit të lejeve minerare përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
- ❖ Kur jepen koncesione të burimeve minerale, afati për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.²⁵

²⁴ Endri Papajorgji 2014 "Concessions in Albania and Macedonia in Comparative Law" Vol 3 (f.461-462)

²⁵ Ligji Per koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, Shqipëri, (AL- Ligji nr. 125/2013)

Kriteret për dhënien e koncesionit

- ❖ Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit që përfshijnë cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike, funksionale e të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit.
- ❖ Komisioni i dhënies së koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej kritereve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Këta koeficientë mund të shprehen duke parashikuar një gamë më një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, autoriteti kontraktues tregon në njoftimin e kontratës kriteret, sipas rendit zbritës të rëndësisë.
- ❖ Nëse ndonjë akt tjetër ligjor që rregullon koncesionet përcakton tarifën më të ulët të koncesionit, të cilën koncesionari është i detyruar ta paguajë, atëherë autoriteti kontraktues e deklaron këtë shumë në dokumentet e tenderit, si shuma të cilën ofertuesit duhet ta përfshijnë në ofertat e tyre.
- ❖ Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit.²⁶


Autoriteti kontraktues nuk mund të lidhë kontratën para skadimit të periudhës së pritjes së ankesave, e përcaktuar në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik. Autoriteti kontraktues fton ofertuesin më të suksesshëm për lidhjen e kontratës jo më vonë se 10 ditë nga data e skadimit të periudhës së pritjes së ankesave.

Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/ partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizmin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.), pasi këto janë të përcaktuara nga dokumentet e tenderit dhe/ose vendimin për zgjedhjen e ofertës më të suksesshme.

Liçencimi: Proçesi i liçensimit, dhënies së lejeve minerare ka filluar në fillim të fazës së tretë, në vitin 1995. Deri më 01.01.2018 janë dhënë gjithsej rreth 711 leje minerare. Nga këto, leje shfrytëzimi janë dhënë 622. Numri I lejeve të shfrytëzimit për disa minerale kryesore është si më poshtë:

²⁶ Ligji për minierat dhe minerale në SHqipëri Ligj nr. 125/2013 datë 25.4.2013


Grafikoni 4. Lejet per shfrytezim te burimeve minerale



Burimi: Raporti Vjtor dhe kalkulimi nga autori

Nga grafikoni mund te verejm se Shqiperia eshte nje vend qe pjesen me te madhe perbene mineralin e kromit qe eshte nje mineral me I rendesishem ku Shqipëria njihet si një vend me potencial të lartë kromi, krahasuar me vendet e tjera të Mesdheut. Depozitat kryesore të këtij minerali ndodhen në Ofiolit të zonës së Rymës Lindore, përgjatë drejtimit Tropoja-Kukës-Bulqiza-Shebenik. Ku sot numri i lejeve te shfrytezimit te burimeve minerale eshte shume i larte krahasuar me vitet e 2005 ku nr i ljeve nuk ka kaluar numrin mbi 255 leje shfrytezimi, gjatë vitit 2017 janë dhënë rreth 202 leje për Kromin ndërsa 207 leje janë dhëne për Gur gelqeror ku shohim se burimet metalike zën një vend të rëndësishëm në burimet minerale ku për Hekur-Nikel me 32 leje minerale që ajo realzionë të ardhura të konsiderueshme në burimet minerale si bazë për shfrytezim dhe zhvillim te sektorit mineral duke siguruar rritjen ekonomike.

Grafikoni 5.Nr i lejeve per shfrytezim te burimeve minerale ne Shqiperi



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Nga grafikoni 5. mund të vërejm se lejet për shfrytezim të burimeve minerale janë rritur dukshëm në krahasim me vitet e mëparshme, shfrytezimi sa më i lartë i burimeve minerale bën që qeveria të fitoj të ardhura nga renta minerale sepse 75% të ardhurat nga minerale shkojnë në buxhetin e shtetit dhe 25% shkojnë në qeverisjen lokale për administrimin dhe mbikqyrjen e vendeve të burimeve minerale.

Tabela 5. Renta minerale në vlerë dhe në ton në Shqipëri.


renta minerale			
	ton	vlere-LEK	VLERA NE EUR
2012	621.581	714,000,000.00	5,644,268.77
2013	662.117	776,652,000.00	6,139,541.50
2014	821.556	838,784,160.00	6,630,704.82
2015	1.006.175	857,633,000.00	6,779,707.51
2016	1.118.175	901,810,000.00	7,128,932.81
2017	1.139.507	1,708,418,000.00	13,505,280.63

Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Cdo person fizik ose juridik i cili është i licencuar dhe vepron në industrinë minerale sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë duhet të paguaj qira për burimet natyrore të nxjerra nga, nën dhe mbi tokën e Republikës së Shqipërisë. Renta minerale llogaritet si një detyrim mujor i tatimit paguesit në kohën kur ai shet produkte minerale në rast të eksportit të burimeve minerale qiraja paguhet

me deklaraten e eksporti te burimeve minerale ndersa 25% te rentes minerale i kalon pushtetit lokal ku kryhet aktiviteti. Ne vitin 2017 kemi pasur nje rritje te rentes minerale Ndikim kryesor ka patur rritja e çmimit të mineraleve në tregun ndërkombëtar dhe rritja e sasisë së mineraleve të eksportuara me ndryshim prej 1,396,000 Euro kjo si pasoj e ndryshimeve te cmimeve ne tregut nderkombetar.


Grafikoni 6. Renta minerale gjatë viteve në Shqipëri 2012-2017



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Nga grafikoni ne mund te konkludojmë se viteve te fundit kemi nje rritje te rentes minerale kjo mund te jet si pasoj e rritjes se tarifes per shfrytezimin e burimeve minerale ndersa nga ana tjetere edhe numri i lejeve per shfrytezim eshte i larte. Meqenëse mineralet janë pronë e shtetit, është shumë e qartë se qëllimi final i shtetit është maksimalizimi i përfitimit nga resurset minerare. Mirëpo, ngritja e shkallës së rentës minerare nuk do të thotë edhe maksimalizim i përfitimit, sepse nëse vendosim rentë minerare të lartë, atëherë do të kemi investime më të vogla në këtë sektor. Çdo investitor qëllimin e tij e ka profitin, prandaj është një mjeshtri e veçantë që të gjendet një optimum i shkallës së rentës minerare, me anë të së cilës do të përfitojë vetë shteti, si dhe në të njëjtën kohë të këtë investime në këtë sektor, nga të dhënat shohim qartë se viti 2017 paraqet edhe njëherit vitin më fitim prurës që konsiderohet se ka realizuar të ardhura më të larta nga renta minerale apo 13 milion Euro kjo si pasoj e ndryshimit te cmimeve në tregun ndërkombëtar sepse pjesa më e madhe eksportohet, ku paraqitet një bazë positive që vendi të njihet si një eksportues të burimeve minerale dhe bazë për zhvillimin e sektorit minerar.

Grafikoni 7. PBB e sektorit të minierave në Shqipëri



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

PBB-ja nga miniera në Shqipëri u rrit në 4.204 milion Euro në tremujorin e parë të vitit 2018 nga 3.696 milionë Euro në tremujorin e katërt të vitit 2017. PBB-ja nga miniera në Shqipëri mesatarisht ishte 324.130 milion Euro nga viti 2009 deri në vitin 2018, duke arritur një kohë të gjatë prej 4.204 milion Euro në tremujorin e parë të vitit 2018 dhe një rekord të ulët prej 236.137 Euro Milion në tremujorin e tretë të vitit 2009.²⁷


Nga të dhënat konkludojmë se Minierat në Shqipëri në vitet e fundit kemi një rritje në Rentën minerale në PBB e vendit duke kontribuar në rritjen ekonomike kjo si pasojë e rritjeve të çmimeve të tregut ndërkombëtar dhe rritjen e shfrytëzimit të burimeve minerale ku paraqet një bazë të suksesshme për zhvillimin e sektorit mineral ku sipasojë të ardhurave minerale Shteti siguron të ardhura 75% ndërsa pushteti lokal ku zhvillohet aktiviteti prej 25% ku kontribonë në menyrë pozitive në zhvillimin e shtetit dhe pushtetit lokal.

²⁷ Te dhenat e PBB për mineralet në Shqipëri (2012-2017) <https://tradingeconomics.com/albania/gdp-from-mining>

Analiza dhe diskutimi i rezultateve

Rritja ekonomike është një nga objektivat parësore të politikës makroekonomike, sepse një rritje ekonomike e qëndrueshme, do të ndikojë në rritjen e mirëqenien ekonomike të zhvillimit ekonomik dhe rritjen e standartit jetësor. Trazirat politike të 2015-2017 u ngadalësuan rritjen reale e PBB-së në vitin 2017 nga 2.9 % në 2016 në 0.10% në vitin 2017, e mbështetur nga renia e investimeve. Inagurimi i qeveris së re në qershor 2017 zgjidhet ngërçi politik siç dëshmohehet nga kompanitë dhe në të ardhmen pritet që të përmirsohet gjendja në të cilën gjendet dhe të kemi një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Grafikoni 8. i Rritja reale ekonomike ne vendet e Ballkanit



²⁸ **Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori**

Nga grafikoni dhe të dhënat vërejm se Maqedonia në krahasim me vendet e Ballkanit ka një rënie ekonomike gjatë viteve 2015-2017 ku në vitin 2015 patëm rritje ekonomike prej 3.9% në 2016 kemi ulje dhe rritja e ekonomike arrin në 2.9 % përkundrajt vitit 2017 i cili njëherit paraqet vitin e trazirave politike ku kemi rritje vetëm prej 0.10% ku në krahasim me vendet e ballkanit përëndimor krahasohet vendi me rritje më të ulët ekonomike gjatë vitit 2017 kjo vjen sipasoj e trazirave politike poashtu edhe indikatorët tjerë ekonomik kanë pësuar renie sipasoj e trazirave politike që ndodhen në këtë periudhë mirëpo gjatë vitit 2018 parashihet një stabilizim të tregut ekonomik dhe atij politik.

²⁸ Të dhënat e Bankës botrore të dhënat e PBB të rritje ekonomike (2010-2017)

<https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG> (accessed on July, 08, 2018)

Tabela 6. Indikatorët më të rëndësishëm ekonomik në RM


pershkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
rritja ekonomike	2.9	3.8	3.9	2.9	0
PBBcapita Eur	3,921	4,138	4,381	4,687	4,847
papunësia	29	28	26.1	23.7	22.4
borxhi public	40.3	45.8	46.6	48.5	47.6
PBB (Mil eur)	8.1	8.6	9.1	9.7	10.1
norma e inflacionit	2.8	-0.3	-0.3	-0.2	1.4
exporte (Mil eur)	2.4	2.7	3	3.5	4
importet (Mil eur)	4.3	4.5	4.8	5.3	5.8 ²⁹

Burimi:Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Gjatë analizës tonë duke i parë indikatorët më të rëndësishëm ekonomik vërejmë se gjatë vitit 2017 për arsye ekonomike dhe politike shohim që rritja ekonomike është vetëm 0.10%, numri i papunësisë në 22.4 % PBB për banor është 4.847 Euro, borxhi publik prej 47.6% dhe norma e inflacionit prrj 1.4% nga të dhënat vërejmë se viti 2017 shënon njëherit edhe vitin me rritje ekonomike më të ulët dhe se procedura e dhënies të koncesioneve për shfrytëzimin e burimeve minerale luan një rol të rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e sektorit real sepse një pjesë e të ardhurave nga burimet minerale janë në buxhetin e shtetit dhe paraqet të ardhura për at mirpo gjithmonë duhet të pasur kujdes në shfrytëzimin e burimeve minerale në mosdëmtim të shëndetit të njeriut dhe nga ana tjetër të jenë sa më të favorshme në tërheqjen e investitoreve të rinj. Ku gjatë vitit 2017 janë eksploatuar me një sipërfaqe 347.57 km² dhe me eksploatim prej 241,497,877 m³/ton me një vlerë totale prej 514,010,496 .00 Den, ku raportet tregojnë se kemi një rritje të vlerës totale të shfrytëzimit të burimeve minerale sipasoj e rritjes së cmimeve ndërkombëtare të mineraleve si një bazë pozitive për rritjen e motivimit dhe zhvillimin e sektorit të mineraleve.

1. ²⁹ Te dhënat për indikatorët më të rëndësishëm ekonomik në R.Maqedonisë (2013-2017)
http://www.nbrm.mk/osnovni_ekonomski_pokazateli.aspx (accessed on July,08, 2018)


Grafikoni 9. Shfrytëzimi i burimeve minerale



Burimi: Raporti Vjetor dhe kalkulimi nga autori

Ku mund të vërejm se gjatë vitit 2017 koncesionerët e shfrytëzimit të burimeve minerale janë kryesisht për Baker dhe zink nga totali i koncesioneve kemi 37% dhe me një sipërfaqe 104.28 km² ku me pas vjen mermeri me 14% të koncesionereve dhe me sipërfaqe prej 40.81 km², si dhe thengjilli apo qymyri që shfrytëzohet kryesisht për energji elektrike ku e shfrytëzojnë 12% të koncesionerve dhe me sipërfaqe prej 33.10 km² me pastaj vjen shfrytëzimi i koncesioneve tjera. Koncesioni është ndarje e së drejtës për përdorimin e të mirave me interes të përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë ndërsa si koncesioner për shfrytëzimin e burimeve minerale për eksploatimin e tyre janë persona që jetojnë dhe veprojnë mbrenda R. Maqedonisë dhe investitor të huaj ku numri aktual i koncesionereve për burimet e ndryshme minerale është 285 me një sipërfaqe prej 347.57 km², 51 kompani janë bartës të më shumë se një koncesioni. Në krye të listës janë ndërmarrja e ndërtimit Granit dhe Çimentorja Usje me 9 koncesione., USJE ka tre koncesione për gur gëlqeror dhe Marl dhe një tjetër për rërë, opal Breccia dhe rërë kuarci. E treta është PE për rrugë shtetërore e cila zotëron tetë koncesione, katër për rërës dhe zhavorrit, tre gur gëlqeror dhe një nga diabazi, ku subjektet ekonomike me performancë më të lartë janë përfitues të disa koncesioneve dhe janë mbizotruar të tregut në sektorin e mineraleve.

Grafikoni 10.Koncesioneret më të mëdhej të burimeve minerale



Burimi:Raporti vjetor dhe kalkulimi nga autori

Koncesionerët më të mëdhenj të burimeve minerale në bazë të shfrytëzimit të sipërfaqes aktualisht është “Elem” me siperfaqe prej 31.62 km² dhe me nje tarif koncesionare për shfrytëzim të siperfajes prej 7,590,240.00 den qe kryesisht meret me burimet minerale te thengjillit dhe është njeri nder koncesionaret kryesor ndersa pas tij qendron kompania “RI-ENERGETIKA” me nje siperfaqe prej 29.25 km² dhe me tarif koncesionare për shfrytëzimin e sipërfaqes prej 5,266,719.00 den që kryesisht merret me zink baker,ar,argjend, kompania “Granit” si një kompani aksionare ajo ne koncesione merr pjes me 11.438 km² dhe me nje tarif koncesionare prej 1,143,800.00 den e cila kryesisht merret me gur gelqeror,diabaz dhe bazalit ne zona te ndryshme si ne Oher, Kumanov, shkup. Ndersa sa i perket kompanive Shqiptare sipas madhesis e 21 me radh radhitet kompania “Renova” me siperfaqe prej 3 km² dhe me një tarif koncesionare për shfrytëzimin e sipërfaqes prej prej 300,000.00 den dhe kryesisht merret me kuarc dhe perlit,ku vërejm se Koncesioner më të mëdhenj janë kompanitë me performance të lartë ekonomike duke poseduar më tepër se një koncesion dhe duke shfrytezuar sipërfaqe më të madhe ne eksploatimin e mineraleve.

Analiza e koncesioneve të burimeve minerale si pjesë e Industrisë

Sektori i minierave është baza për zhvillimin e industris në një shtet dhe Maqedonia krahasuar me madhësin e saj gjeografike ka një thesar të pacmuar të burimeve minerale dhe është e rëndësishme që ta zhvillojm këtë sektor që të siguroj rritje ekonomike për shtetin dhe të ndikoj pozitivisht në cdo segment të shoqëris. Minierat dhe guoret marin pjesë me 8.31 % ne prodhimin industrial në vend dhe kanë rendësi të madhe për ekonominë. Gjatë periudhës nga viti 2008-2017 kemi nje rritje te sektorit të burimeve minerale si ne kompanitë që veprojnë ne këtë sektor si ne shfrytëzimin e sipërfaqes dhe ne eksploatimin e lëndëve minerale.


Tabela 7. Të dhënat për koncesionet e burimeve minerale në Maqedoni 2008-2017

vitet	Nr I kompanive	Shfrytëzimi I sipërfaqes/km2	eksploatimi/ ton	vlera e shfrytëzimit te sipërfaqes	vlera e eksploatimit	vlera totale
2008	104	312	54,251,047	33,444,084.00	169,289,107.00	202,733,191.00
2009	144	306	78,329,431	33,868,296.00	172,283,920.00	206,152,216.00
2010	164	476	79,853,620	30,332,258.00	332,151,315.52	365,574,199.51
2011	176	272	8,820,613	34,694,030.00	456,891,064.00	487,320,365.92
2012	182	279	93,439,997	35,900,877.00	439,759,446.00	475,660,323.00
2013	164	311	107,362,435	40,837,592.00	396,097,435.00	436,935,027.00
2014	180	310	97,781,386	41,565,527.00	354,625,375.00	396,190,902.00
2015	173	374	195,303,412	49,116,152.00	387,730,960.00	436,847,112.00
2016	189	392	187,012,711	56,831,359.00	381,948,864.00	438,780,223.00
2017	201	377	241,497,877	52,501,315.00	461,509,181.00	514,010,496.00

Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga të dhënat mund të konkludojmë se kemi një rritje të koncesioneve të burimeve minerale si në shfrytëzimin e sipërfaqes ne km2 poashtu edhe në ekplotimin m3 ku koncesionet e burimeve minerale ndikojne pozitivisht ne buxhetin e shtetit dhe në nivelin komunal ku gjate periudhës së analizuar shohim që viti 2016 kemi shfrytëzim më të lartë të sipërfaqes së burimeve minerale prej 392 km2 me një vlere prej 56 miljon den ku gjatë vitit 2017 kemi një zvoglim prej 7.6% si pasoj e keqëpërdorimit të disa koncesioneve dhe marja e tyre nga qeveria mirpo kemi rritje te eksploatimit dhe të vlerës totale sipasoj e rritjes se cmimit ndërkombëtar të burimeve minerale.

Grafikoni 11. Të dhënat për shfrytëzimin e burimeve minerale 2008-2017




Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga të dhënat gjatë periudhës që kemi në analiz shohim se nga viti 2008-2017 kemi trende rritje dhe rritje të ndikuara nga situatat e ndryshme ekonomike dhe politike si dhe ndikimi i stabilitetit të tregut të mineraleve ku viti më i sukseshëm sa i takon të ardhurave të realizuara nga sektori i burimeve minerale paraqitet viti 2017 me 514 milion den të ardhurave në total ky është si rezultat i rritjes së cmimit në tregun e mineraleve që këto të ardhura ndikojnë pozitivisht në shtetin dhe në pushtetin lokal ndërsa si vit me realizimin e të ardhurave më të ulta paraqitet viti 2014 me zvogim prej 10.2% në raport me vitin 2013 si pasojë e situatave të ndryshme ekonomike politike dhe ndryshimeve të cmimeve të tregut të mineraleve ku gjatë viteve në vazhdim shohim një rritje të ndjeshme të këtij sektori duke përmirësuar edhe mënyrën e shfrytëzimit të burimeve minerale dhe duke u vetëdisuar se nga ky sektor mund të realizojmë të ardhura të larta dhe të bëhet njeri ndër sektoret për eksportet më të mëdha në vend duke e rritur edhe industrinë që të ndikojë në mënyrë pozitive edhe në mirëqenien e përgjithshme.

Si pjesë e industrisë burimet minerale zënë një vend të rëndësishëm sot pothuajse e kapin vlerën 8.31% të industrisë ku kemi një rritje si në numrin e të punësuarve si në PBB të mineraleve dhe gurethyesve dhe rritje në prodhimin total nga burimet minerale. Prandaj mineralet zënë një vend të rëndësishëm në sektorin e industrisë, në vendin tone ka qytete që janë themeluar pranë depozitave dhe minierave të hapura për shfrytëzimin e metaleve prandaj kjo industri në asnjë mënyrë nuk duhet të neglizhohet, por duke u nisur nga fakti se disa komuna të caktuara në vend plotësisht janë të varura në funksionimin e një miniere, kjo qeveri do të bëjë gjithçka për të siguruar shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale.

nga investorët nëpër miniera duke i kushtuar njëkohësisht vëmendje maksimale ruajtjes së mjedidit dhe mirëqenies sociale të popullsisë përreth.

Grafikoni 12. PBB dhe Bruto Prodhimi i burimeve minerale 2008-2017




³⁰ **Burimi: kalkulimi nga autori**

Nga të dhënat vërejm se PBB dhe prodhimi bruto i mineraleve gjatë periudhës në analizë kemi kryesisht trende rritese ku gjatë vitit 2017 i cili konsiderohet si viti më i suksesshem në sektorin e mineraleve me një PBB prej 9.424 milion den dhe me bruto prodhim prej 16.152 milion den rritja viteve të fundit kryesisht i adresohet ndryshimi i cmimeve në tregun ndërkombëtar dhe rritjes së stabilitetit dhe rritja e shfrytëzimit të burimeve minerale e cila ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit ku PBB e minierave dhe gurthyesve gjatë vitit 2017 merr 1.52% në PBB e vendit prandaj minierat dhe mineralet kanë një rëndësi të vacantë në zhvillimin e vendit prandaj studimi fokusohet në mineralet si pjesë e zhvillimit dhe mbrojtjen e mjedisit gjithashtu edhe pjesë e zhvillimit të vendbanimeve rurale.

³⁰ Statistike rreth PBB per miniera dhe minerale(2008-2017) <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=7> (accessed on August,02, 2018)

Grafikoni 13. Pjesmarja e PBB-se minerale ne totalin e PBB




Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Nga të dhënat shohim se pjesmarja e minierave në PBB e vendit luan një rol të rëndësishëm ku shohim gjatë vitit 2017 ajo merr pjes 1.52% në PBB totale duke ndikuar edhe në rritjen ekonomike të vendit. Në zhvillimin e ekonomisë së përgjithshme Maqedonase, industria ka një vend shumë të rëndësishëm, zhvillimi i shpejtë i industrisë është një nga nxitësit kryesorë të gjithë zhvillimit ekonomik, ndryshimi i marrëdhënieve socio-ekonomike, mënyra e jetesës së popullsisë, rritja e interesit për progresin teknik etj. Prandaj minierat dhe gurethyesit luane një rol të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë, ku kemi llogaritur indeksin e prodhimit industrial të minierave në tregut vendor dhe në tregun e përgjithshëm prodhimin industrial dhe indeksin e numrit të punësuarve, ku Indekset e çmimeve të prodhuesve industrialë, gjithsej, matin ndryshimet në nivelet e çmimeve të prodhuesve industrialë të industrisë të produkteve të prodhuara në Maqedoni dhe të shitura në tregun e brendshëm dhe në tregun e jashtëm.³¹

Ku kemi rritje të indeksit të cmimit të prodhimit mineral që ndikojë në menyrë pozitive në rritjen dhe zhvillimin e sektorit të minierave ku shohim si pasojë e rritjes së indeksit të cmimit të prodhimit industrial në sektorin e minierave kemi rritje të të ardhurave ku ajo gjatë vitit 2017 arriti deri në 514 milion denar ku 22% e atyre u adresohen buxhetit të shtetit dhe 78% janë të ardhurat e pushtetit lokal ku zhvillohet aktiviteti.

1. ³¹ Statistikat rreth mineraleve si pjesë e industrisë Raporti vjetor 2017 <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=19> (accessed on July, 18, 2018)

Grafikoni 14. Indekset e prodhimit industrial ne sektorin e mineraleve



Burimi: Raportet Vjetore dhe kalkulimi i autorit

Indekset e prodhimit industrial në sektorin e mineraleve gjate vitit 2017 kanë shenuar ulje ku është ulur për 11.5% në krahasim me vitin 2016 por gjithashtu kemi ulje edhe në numrin e punesuar në tregut e mineraleve dhe gurthyesve me një përqindje të vogël prej 2% ndërsa rritja më e madhe në sektorin e minerale në tregun e përgjithshëm është në vitin 2016 ku shenone rritje prej 13.7% dhe gjate gjithë kësaj periudhe shikojmë se në sektorin e industrisë së minierave raporte me të larta pozitive shenojnë gjate vitit 2016 ku kemi rritje të prodhimit industrial të mineraleve edhe në tregun e mbredshëm edhe në tregun e jashtëm.

Analiza e kriteriumeve dhe objektivat e dhënies së koncesioneve

Koncesioni për hulumtime gjeologjike të detajuara jepet në bazë të një thirrjeje publike me ankand elektronik, me përjashtim të kompanive publike, institucioneve publike, si dhe subjekteve që janë pronarë të tokës ku koncesioni kërkohet për burimet minerale si rëra apo kuarc kolektiv, ku koncesioni jepet në bazë të kërkesës. E drejta për të marrë pjesë në thirrjen publike ka të gjitha subjektet vendas dhe të huaj ligjore dhe konsorciume që do të marrë dokumentacionin e tenderit nëpërmjet www.e-koncesii.mk sistemit elektronik dhe do të përmbushin kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Dokumentacioni i tenderit përmban informacion në lidhje me faqet që janë për caktimin koncesione për hulumtime detale gjeologjike dhe vlera e projektit të koncesionit shprehur si fillimin e vlerës së koncesionit dhe kushtet që duhet të përmbushen nga koncesionari.

Ofertuesit e kërkuara nga sistemi www.e-koncesii.mk duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm për dëshmi të kushteve personale, profesionale dhe financiare që duhet të plotësohen për pjesëmarrje në thirrjen publike:

- ❖ një dokument për një aktivitet të regjistruar të biznesit,
- ❖ një deklaratë nga ofertuesi se nuk është shqiptuar një aktvendim efektiv në lidhje me pjesëmarrjen në organizimin kriminal, korrupsionin, mashtrimin apo pastrimin e parave në pesë vitet e fundit,
- ❖ një vërtetim se procedura e falimentimit nuk është iniciuar nga një organ kompetent,
- ❖ një vërtetim që një procedurë likuidimi nuk është iniciuar nga një organ kompetent,
- ❖ një certifikatë që nuk vendos një sanksion efektiv kundërvajtës mbi praktikën profesionale, kryerjen e një veprimtarie ose detyre, përkatësisht një urdhëresë për të kryer një aktivitet të caktuar,
- ❖ një certifikatë të taksave dhe kontributeve të paguara,
- ❖ një vërtetim se nuk vendos një dënim efektiv për një vepër penale, dhe
- ❖ raporte pozitive financiare, për vitin e kaluar.

Ofertuesit duhet të dorëzojnë garancinë e tenderit në origjinal përmes arkivave të Ministrisë së Ekonomisë. Ofertuesit mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për vendet për dhënien e një koncesioni për eksplorime të detajuara gjeologjike. Ofertat duhet të jenë të vlefshme për një vit nga data e hapjes publike. Aplikimi i thirrjes, ofertuesi i interesuar është i detyruar të paguajë grante me vlerë 6,000.00 denarë. Oferta dorëzohet nëpërmjet portalit www.e-koncesii.mk, dmth. Vetëm garancioni i tenderit dorëzohet përmes arkivit të Ministrisë së Ekonomisë.

Oferta duhet të përmbajë si vijon:

- ❖ Letër ofertuese,
- ❖ Garancia e tenderit dhe
- ❖ dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit,

.Kriteriumet gjatë përzgjedhjes së ofertave më të favorshme gjatë periudhës së analizuar janë:

- Gjatë zgjedhjes së ofertuesit më të favorshëm do të merren parasysh vetëm ofertat që përmbajnë dokumentacionin e plotë të përcaktuar në Dokumentacionin e Tenderit
- Cilësi
- Karakteristikat teknike

- Karakteristikat funksionale, mjedisore,
- tarifa më e lartë e cila ofrohet në koncesion, por jo më pak se çmimi fillestar për lokalitetin dhe subjektet e burimeve minerale
- Kushti për vlerësimin e ofertave është një garanci e duhur e tenderit.

Ku secili element përmbanë pikë gjatë vlerësimit të ofertave dhe duke i poseduar dokumentat e nevojshme të cilat do të vlerësohen me pikë dhe tarifa më e lartë e ofruar ku do të përzgjidhet ofertuesi ekonomikisht më i favorshëm.

Vlerësimi i ofertave do të bëhet në dy faza:

- ❖ Faza e parë: Plotësia dhe vlefshmëria e dokumentacionit të detyrueshëm. Nëse konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë, oferta financiare nuk merret parasysh dhe ofertuesi nuk lejohet të marrë pjesë në ankandin elektronik.
- ❖ Faza e dytë: pas përcaktimit të plotësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit nga Komisioni, shqyrtimi i ofertave financiare është miratuar dhe është miratuar qasja për pjesmarjen në sistemin e ankandit elektronik.³²

Nga analiza e kriteriumeve të përcaktuara nga Ligji i burimeve minerale nr.136/2012 vë në dukje se dokumentet e nevojshme që duhet të plotësojë një subjekt ekonomik për të marrë pjesë në ankandin elektronik gjatë dhënies së koncesioneve bëjnë më të favorshme kompanitë që kanë kredibilitet më të lartë përkundrejt kompanive me gjendje më të dobët ekonomike ku rëndomtë tarifa më të larta koncesionare ofrojnë edhe kompanitë që kanë plotëfuqishmërinë e tregut dhe kjo mundesonë që të zgjidhet kompanitë me performancë të lartë ekonomike ku kjo vërtetonë hipotezën se **Kriteriumet dhe kushtet e ndërlikuara që duhet të plotësojnë subjektet ekonomike i marginalizojnë firmat ekonomike me performance të vogël dhe mundesoj të zgjidhet firmat me performance ekonomike më të lartë.**

Për të zhvilluar dhe për të rrit konkurrencën dhe diversifikimin e fituesve të koncesioneve duhet që të bëjë inkurajimin edhe të kompanive në vende më pak të zhvilluara duke ofruar kriteriume më të lehta: Zvoglimin e kushteve financiare që firmat duhet të plotësojnë, motivimin e koncesionerve në vendet më pak të zhvilluara dhe prioritet të jenë kompanitë që ndodhen në at lokacionin ku zhvillohet aktiviteti, dhe më tepër rëndësi të kushtojnë dokumenteve se sa tarifës koncesionare të ofruar, si dhe ndryshime fiskale duke ofruar tarifa më të ulta për shfrytëzimin e burimeve minerale.

³² Ligji i burimeve minerale (Rm-nr.136/2012)


Gjatë vlerësimit të kriteriumeve të dhënies së koncesioneve ku ofertuesit rëndësi duhet ti kushtojnë dokumentacionit të tenderit që të kenë të plotë dhe tarifes në të cilën do ta ofrojnë për të fituar tenderin e burimeve minerale. Ndërsa gjatë vitit 2018 në tenderin për lokacionin “SAMARNICA” i cili i takon komunes së Dolnenit dhe Prilepit ofertuesit për të mar pjesë në Tender ata duhet :

- ❖ Letër ofertuese,
- ❖ Të paguajne nje garante me vlerë 6,000.00 denarë.
- ❖ dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve personale, profesionale dhe financiare të ofertuesit,

ku ofertuesi më i mirë do zgjidhet në bazë të dokumuntacioneve të kompletuar,si dhe tarifa më e lartë e ofruar në ankandit elektronik nepermjet sisitemit www.e-koncesii.mk ku ky koncesion jepet në periudh prej dy vjet për një gur arkitektonik-zbukurues.

Te ardhurat që do të realizohen nga ky lokalitet parashihet qe 27% te takojne Komunes së Prilepit,51% Komunes së Dolnenit dhe 22% buxhetit të RM.

Grafikoni 15. Ndarja e të ardhurave nga lokaliteti “SAMARNICA”




Burimi:Kalkulimi nga autori

Nga të ardhurat që do të realizojnë nga ky aktivitet parashihet si njëri nga Lokacionet me të ardhura të larta qe do të arrij të përfitoj Shteti,pushteti lokal i Prilepit dhe i Dolnenit për arsye të burimeve të cmueshme minerale që i posedon prandaj gjatë analizës së procesit të tenderimit gjatë këtij lokacioni ku kemi një numër të madh te subjekteve ekonomike të interesuar të cilat ofrojnë tarifa të ndryshme

koncesioneve me qëllim që ta përfitojnë këtë lokalitet dhe të zhvillojnë aktivitet ekonomik. Në bazë të kriteriumeve që duhet të plotësojnë në dokumentacionin e tenderit kushtet ekonomike profesionale dhe financiare si dhe tarifës më të lartë të ofruar do të bëhet përzgjedhja e ofertuesit ekonomikisht më i favorshëm, ku në bazë të tarifës më të lartë të ofruar ky tender arriti që të përfitoj të ardhura nga tenderi në vlerë prej 448.570.000,00.³³

Grafikoni 16. Të ardhurat e përfiturat nga Lokaliteti “SAMARNICA”



Burimi: Kalkulimi nga autori

Nga ky lokalitet që meret me lëndën Mermer pritet që të ketë përfitime jo vetëm në buxhetin e shtetit por të përfitoj edhe në rafshin komunal prandaj disa komuna thjesht mbijetojnë si pasojë e zhvillimit të burimeve minerale. Ku në bazë të tarifës së ofruar në tender kemi përfitime të konsiderueshme ku nga ky komunës së Dolnenit i takojne 227.424.990,00 den apo 51 % a të ardhurave të përfituara nga ky tender ndersa Komunës së Prilepit do te takojne 122.459.610,00 den apo 27 % nga të ardhurat totale ku buxhetit të shtetit i takonë 22 % apo 98.685.400,00 den ndërsa si shume totale nga ky lokalitet 448.570.000,00 den prandaj shteti duhet që koncesionerët ti zgjedh me një vlerësim në bazë të meritave duke mos i keqpërdor burimet koncesionere duke i parë të ardhurat që do ti realizojnë nga ky tender , shteti gjithmonë tenton që të zhvilloj këtë sektor mirpo duke mos shkaktuar pasoja ne mjedisin jetësor dhe në shëndetin e njeriut.


³³ Thirja publike për lokalitetin Samarnica nr 1-2018 <http://www.economy.gov.mk/doc/2333> (accessed on September, 17, 2018)

Analiza e procesit të dhënies së koncesioneve sipas rajoneve dhe kompanive fituese në RM

Procesi i dhënies së koncesioneve luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e vendit në tërësi por edhe në rafshin komunal sepse disa komuna janë zhvilluar si pasojë e zhvillimit të shfrytëzimit të burimeve minerale dhe përfitimi komunal është i lartë sipasoj e këtyre burimeve praj procesi i dhënies së koncesioneve në bazë të rajoneve dhe kompanive fituese është i rëndësishëm se paraqet edhe zhvillimin e disa rajoneve që kanë shfrytëzim më të madh të burimeve minerale.

Struktura e koncesioneve të burimeve minerale sipas rajoneve është :

Grafikoni 17. Koncesionet e kompanive fituese në bazë të rajoneve



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga vlera totale si shfrytëzimi i sipërfaqes dhe eksploatimi shohim se rajoni Lindor ka pjesëmarrje më të madhe në shfrytëzimin dhe eksploatimin e lendeve minerale në total me 52.3% më pastaj vjen rajoni i Shkupit me 35.2% ndërsa rajoni i Pollogut me pjesëmarrjen më të ulët në vlera totale me 1.57%, mund të vërejmë se rajoni i Shkupit dhe ai i Lindor paraqesin edhe njëherit rajonet më të zhvilluara në vend prandaj burimet minerale dhe eksploatimi i tyre paraqet edhe një faktor për zhvillimin e vendit në rafshin komunal.


Tabela 7. Kompanitë fituese të koncesioneve në bazë të rajoneve

RAJONET	sipërfaqja km2	vlera ne denar	Totali i eksploatimit min. lënda e parë m3 / ton	kuartali total vjetor (i paguar)	vlera totale
RAJONI I SHKUPIT	171	20,172,173.00	68,127,648	MKD 157,546,062.00	MKD 177,611,615.00
Rajoni I PELLAGONISE	34	1,045,191.00	11,192,621	MKD 36,735,136.00	MKD 37,780,327.00
RAJONI I VARDARIT	8.846789	421,280.00	28,925,054	MKD 6,095,374.00	MKD 6,516,654.00
RAJONI JUGLINDOR	11.891393	1,638,022.00	499,166	MKD 7,028,056.00	MKD 8,666,078.00
RAJONI LINDOR	71.161313	12,002,533.00	111,762,051	MKD 255,019,787.00	MKD 267,022,320.00
RAJONI VERILINDOR	8.166132	1,042,619.00	326,759	MKD 296,787.00	MKD 1,339,406.00
RAJONI I POLLOGUT	12.126278	935,147.00	631,494	MKD 5,332,953.00	MKD 6,545,581.60
RAJONI JUGPERENDIMOR	8.4547779	1,591,975.00	761,866	MKD 6,936,539.00	MKD 8,528,514.00
Totali	325	52,501,315	241,497,877	MKD 461,509,181.00	MKD 514,010,496.00

Burimi:Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Nga pjesmarja e rajoneve në koncesione vërejm se rajoni Lindor shfrytezon një sipërfaqe prej 72 km² me një tarif koncesionare prej 12 milion den dhe me eksploatim prej 111 milion ton me tarif prej 255 milion den dhe në shumën totale prej 267 milion den apo nga totali prej 52 % ndersa me pas e ndjek rajoni i Shkupit me sipërfaqe më të madhe prej 172 km² dhe me eksploatim prej 68 milion ton apo me shumë totale prej 177 milion den apo 34 % e vleres totale ndersa rajoni i pollogut apo pjesmarjen e popullsisë Shqiptare kemi 13 km² me një tarif koncesionare prej 935.147 den me eksploatim prej 5 milion ton ne vlerë prej 8 milion den apo 2 % ne nivelin total ku mund të vërejm se ne rajoni i pollogut është edhe rajoni më i ulët sa i përket shfrytëzimit të burimeve minerale,prandaj shteti për të stimuluar edhe vendet me të varfura duhet të zvoglojë kriteret dhe të stimulojë kompanitë me të vogla për të fituar një koncesion të burimeve minerale. Gjatë periudhës në analizë vërejm se gjatë viteve të fundit kemi trendëse rritëse të shfrytëzimit të koncesioneve të burimeve minerale ku kryesisht viti 2016 konsiderohet si viti me shfrytëzim më të madh të sipërfaqes koncesionare me sipërfaqe prej 392 km² ndërsa 2017 kemi zvoglim në 377 km² ku në bazë rajonale gjatë viteve shohim se kemi trendëse rritëse dhe ramëse ku kryesisht i adresohet viteve të fundit rritjes së cmimit në tregun ndërkombëtar të burimeve minerale, rritjes së stabilitetit në shfrytëzimin e burimeve minerale ku se si kanë lëvizur trenden e burimeve minerale në bazë rajonale më qartë e kemi paraqitur në grafikonin e 18.

Grafikoni 18. Vlera e shfrytëzimit të burimeve minerale në bazë rajonale



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga grafikoni 18. mund të konkludojmë se Rajoni i Shkupit dhe ai i Lindor viteve të fundit shfrytëzimi i burimeve minerale gjithmonë shkon duke u rritur si pasojë rritjes së eksploatimit të shfrytëzimit të tyre dhe rritjes së sipërfaqes për të shfrytëzuar nga koncesionerët e këtyre rajoneve dhe si pasojë e ndryshimit të çmimit të tregut ndërkombëtar të mineraleve përkundërt. Rajoni i Pollogut dhe Jugperendimor paraqiten edhe njëherë rajoni si më pak të përdorimit të burimeve minerale ku këta rajone njëherë përfitojnë nga këto burime ku 78 % të vlerës i takojnë komunës ku kryhen aktiviteti dhe 22% i takojnë buxhetit të shtetit, ku vërejmë se Rajoni i Lindor dhe ai i Shkupit paraqiten njëherë edhe fituesit më të mëdhenj të burimeve minerale ndërsa rajoni i Pollogut paraqitet si njëherë si fitues më i vogël i koncesioneve të burimeve minerale dhe dhënia e koncesioneve në këtë rajon kryesisht është në shifra të ulëta ku këta të dhënat gjatë periudhës konkrete vërtetojnë hipotezën se **shumica e koncesioneve minerale jepen në Rajonin Lindor dhe të Shkupit ndërsa në rajonet planore lejet koncesionare janë minimale me theks të vecantë të kompanive shqiptare.**

Rajoni i Pollogut paraqet rajoni i cili i takon popullsisë Shqiptare ku kryeqendra e saj është Tetova, për sa i përket zhvillimit të saj rajoni i Pollogut paraqet njëri ndër rajonet më pak të zhvilluar krahasuar me rajonet tjera, banorët e rajonit të Shkupit kanë në vit 366,482 den prodhim të brendshëm bruto për kokë banori, ndërsa banorët e rajonit të Pollogut me 117,284 den për kokë banori kanë prodhimin më të ulët të brendshëm në Maqedoni krahasuar me rajonet tjera ku me pak 3 herë zhvillim se rajoni i Shkupit ndërsa sa i përket mineraleve dhe gurethesve rajoni i Pollogut krahasuar me rajonet tjera paraqet njëherë edhe rajonin më pak të zhvilluar ku kemi një numër të vogël të kompanive që veprojnë në këtë sektor apo në total prej koncesioneve minerale i takojnë vetëm 2 % apo me një vlerë totale vjetore prej 6.5 milion den.


Tabela 8. Vlera e shfrytëzimit të burimeve minerale të kompanive fituese në Rajonin e Pollogut

Rajoni Pollogut	sipërfaqja km2	Shuma e pagesës për kontratë	paguar ne denar	Totali i eksploatimit min. lënda e parë m3 / ton	kuartali total vjetor (l paguar)	vlera totale
2008	17.00	1,699,940.00	1,510,150.00	269,353	2,492,890.00	4,003,040.00
2009	15.18	1,797,590.00	1,593,650.00	295,279	2,781,542.00	4,375,192.00
2010	18.00	1,807,450.00	1,562,050.00	318,323	3,096,401.00	4,658,451.00
2011	16.83	1,690,450.00	1,434,050.00	523,854	4,788,431.00	6,222,481.00
2012	16.89	1,689,163.00	1,530,304.00	533,968	4,937,755.00	6,468,059.00
2013	14.74	1,402,960.50	1,005,452.21	493,371	4,464,812.00	5,470,264.21
2014	14.12	1,442,407.80	1,304,513.00	477,900	4,367,144.00	5,671,657.00
2015	17.09	1,812,277.10	1,619,295.00	593,137	5,354,602.00	6,973,897.00
2016	17.50	1,853,747.40	1,385,167.00	573,996	5,296,507.00	6,681,674.00
2017	12.13	1,212,628.60	935,147.00	631,494	5,698,245.00	6,633,392.00

Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga tabela mund të vërehet se kemi një përqindje të ulët të përdorimit të burimeve mineral ku nga periudha 2008-2017 kemi shumë pak ndryshim të përdorimit të burimeve minerale pothuajse të njëjtat kompani shfrytëzojnë sipërfaqe të njëjta dhe eksploatime të njëjta me një sipërfaqe mesatare prej 17 km² me eksploatim prej 631.494m³ dhe me një vlerë totale prej 6.5 milion den për kundërt rajoneve të tjera, prandaj qeveria duhet të stimuloj edhe kompanit me performancë me të vogël ekonomike.


Grafikoni 19. Vlera e koncesioneve minerale në Rajonin e Pollogut



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga grafikoni 19. mund të vërejm se Rajoni I Pollogut gjatë kësaj periudhe vlera më e lartë e shfrytëzimit të burimeve minerale ishte në viti 2015 me një vlerë totale prej 6.9 milion den konsiderohet si viti më i suksesshem gjatë periudhës në analizë sipasoj e rritjes së prodhimit të eksploatimit në m3 dhe ndryshimit të cmimit të tregut të mineraleve edhe pse viti 2017 kemi shfrytëzim më të vogël të sipërfaqes i cili nga 17 km2 bie në 12 km2 mirpo për shkak të ndryshimit të cmimit në tregun e mineraleve kemi rritje të prodhimit që do të ndikojë në vlerën totale me 6.6 milion den apo zvoglim krahasur me viti 2015 prej 4.87% .

Grafikoni 20. Vlera e koncesioneve minerale në Rajonin e Shkupit



Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi i autorit

Nga grafikoni 20. Vërejm qartë se kemi rritje të dukshme të kompanive fituese të koncesioneve të burimeve minerale dhe paraqitet njëri ndër rajonet me zhvillim më të lartë ku të ardhurat për banor janë 3 herë më të larta se Rajoni i Pollogut prandaj dhënia e koncesionit në këtë rajon është me shifra të larta ku gjatë periudhës në analizë kemi trende rritëse dhe ramse ku njëherit viti 2017 konsiderohet si viti më i suksesshem sa i përket kompanive fituese të koncesioneve minerale ku vlera totale arriti në 177 milion den i cili i adresohet rritjes së prodhimit sipasoj e ndryshimit të cmimit të tregut të mineraleve.

Analiza e sistemit të pagesave të koncesioneve të burimeve minerale

Sistemet e pagesave janë kanalet nëpërmjet të cilave bëhet transferimi i fondeve ndërmjet bankave, si dhe janë një nga rrugët kryesore nëpërmjet të cilave krizat financiare mund të transmetohen në sistemet dhe tregjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Sistemet e pagesave, të sigurta dhe të qëndrueshme, janë kërkesat kryesore për nxitjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Sistemi i pagesave i koncesioneve

minerale luan një rol të rëndësishëm sepse ato kontribuojnë në rafshin komunal dhe at te buxhetit të shtetit prandaj qeveria gjithmonë tenton me anë të ligjeve që të bëjnë pagesën në kohe në të kundërt do të ndëshkohen.

Në pajtim me Ligjin për resurset minerale, paguhen këto ndihma:

- ❖ Pagesa për koncesion të hulumtimeve gjeologjike të detajuara
- ❖ Pagesa për koncesion për shfrytëzimin e burimeve minerale
- ❖ -Fondet e ndihmës për kryerjen e eksplorimit të detajuar gjeologjik dhe shfrytëzimin e burimeve minerale në shumën prej:
 - 22% janë të hyra nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe
 - 78% janë të ardhurat e buxhetit të komunës në territorin e së cilës kryhet veprimtaria koncesionare.

Ku Mjetet në vlerë prej 4% që janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë do të përdoren për rekultivim dhe të kthehet në të dobishme në përmirësimin e kushteve të zonave të degraduara në eksplorimet gjeologjike ose në shfrytëzimin e mineraleve. Kur aktiviteti i lidhur i koncesionit është kryer në territorin e disa komunave, fondet e komunës , do të shpërndahen në mënyrë proporcionale të komunave në varësi të madhësisë së zonës për të cilën koncesion është dhënë. Koncesionari që kryen hulumtime të hollësishme gjeologjike të mineraleve do të paguajnë tarifë për shfrytëzimin e zonës, në varësi të llojit të një minerali të përcaktuar në koncesion, për kryerjen e hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Koncesionari që shfrytëzon mineralet do të jetë i detyruar të paguajë:

- ❖ një tarifë vjetore për shfrytëzimin e sipërfaqes së dhënë nga koncesioni i shfrytëzimit, në varësi të llojit të mineralit që është objekt i koncesionit të shfrytëzimit dhe
- ❖ një tarifë për shumën e mineralit të shfrytëzuar, subjekt i koncesionit

Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën e koncesionit për shfrytëzimin e zonës për të cilën është dhënë koncesioni për eksploatimin e mineraleve për secilin vit veç e veç, më së voni deri në 31 dhjetor në vitin aktual. Pagesa e tarifave koncesionit për sasinë shfrytëzuar të mineraleve do të bëhet çdo tre muaj për sasinë të shitura të mineraleve nga koncesionari, Koncesionerët janë të detyruar të paguajnë këto tarifa 15 ditë në muajin vijues pas skadimit të tre muajve që përdoren si bazë për llogaritjen.³⁴

³⁴ Ligji për Minerale, koncesionet dhe Partëriteti privato-Publik ("RM-nr. 136/2012, 25/2013, 93/2013, 44/2014, 160/2014, 129/2015, 192/2015, 39/2016, 53/2016, 120/2016 dhe 189/2016).

Kompania “XYZ” që gjendet në Radovish që kryesisht merret me Bakër gjate periudhes qe e kemi mare ne analize nga viti 2008-2017 ajo ka paguar nje tarif koncesionare vjetore për shfrytezimin e hapesires dhe për sasinë e shfrytëzuar të mineralit të eksploatur ne m3 qe ka shitur dhe është i detyruar të paguaj në cdo tre muaj apo ne 4 kuartale ku gjate viti 2017 ne total ka paguar prej 96 milion den.


Tabela 9. Të dhënat e sistemit të pagesave të kompanisë “XYZ”

	2017	2016	2015
siperfaqja km2	9.77	9.77	9.77
vlere tarifore per shfrytezimit te siperfaqes	1,758,783.00	1,758,783.00	1,758,783.00
pagesa ne kuartalin e I	22,346,327.00	19,226,924.00	24,108,835.00
pagesa ne kuartalin e II	25,443,185.00	20,769,480.00	22,209,199.00
pagesa ne kuartalin e III	25,525,138.00	20,390,931.00	20,059,312.00
pagesa ne kuartalin e IV	21,437,652.00	20,209,205.00	20,561,483.00
kuartali total vjetori eksploatimit	94,752,302.00	80,596,540.00	86,938,829.00
VLERA TOTALE	96,511,085.00	82,355,323.00	88,697,612.00

Burimi: Raportet vjetore dhe kalkulimi nga autori

Nga tabela 9. mund të vërejm qartë se kompania gjatë viti 2017 ka paguar një tarif koncesionare për shfrytezimin e hapsirës prej 1.758.783 den dhe sasin e shfrytezuar te mineralit që ka shitur prej 4 kuartaleve prej 94.752.302 den apo shumën në total që ka paguar prej 96.511.085 ku vërejm se ka pagur një tarif për shfrytezimin e hapsires së njenjtë por kemi ndryshim vetëm ne sasin e eksploatimit të burimeve minerale ku gjate vitit 2017 vërejm se ka rritje ne eksploatimin e lendëve minerale ku kemi rritje të prodhimit si pasoj e ndryshimit të cmimit në tregun ndërkombetar duke krijuar një bazë positive në rritjen e të ardhurave në sektorin mineral dhe ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të vendit, duke krijuar një pasqyrë positive të menaxhimit transparent dhebëre njëherit edhe sektori i 3 më i madh i eksportit të mineraleve në vend.

Grafikoni 20. Vlera koncesionare e paguar nga kompania "XYZ"



Burimi: Raporti Vjetor dhe kalkulimi nga autori

Nga grafikoni 20 mund të vërejm se kompania ka realizuar eksploatim më të madh gjatë vitit 2012 me vlerë prej 97 milion den pastaj kemi një rënie ku në vitin 2014 hasim që kompania ka një rënie në sasinë e eksploatuar ku vlera totale e paguar nga ana e kompanisë arrinë në 42 milion apo një zvoglim prej 55% I cili konsiderohet si viti me prodhim më të ulët përserie kemi rritje gjatë viteve të fundit ku gajte viti 2017 nga pagesa totale prej 96 milion den 78% I takojnë ebuxhetit komunal pra komunes së Radovishit apo 75,278,646.30 den apo 22% i takojnë buxhetit të shtetit në kundërvlerë prej 20,845,506.44 den, Prandaj shumica e komunave që posedojnë burime minerale janë më të zhvilluara sepse një pjesë të madhe të të ardhurave të buxhetit i realizojnë nga ky sektor, disa komuna janë zhvilluar si pasojë e burimeve minerale prandaj ky sektor duhet që të zhvillohet dhe duhet që të mos neglizhohet mirpo gjithmonë duke e ruajtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Kosto-benefit analiza e koncesioneve minerale

Cdo projekt që realizohet në fund priten të merren të ardhura apo përfitime nga ai projekt ,prandaj gjatë dhënies së koncesioneve menjëherë parashtrojmë pyetje: Cili është përfitimi ynë si konsumator, dhe cili është përfitimi i shtetit që jep koncesione të burimeve minerale?

Gjatë dhënies së koncesionit nga ana e shtetit përfitonë jo vetëm kompania po përfiton edhe shteti gjithashtu kemi rritje ekonomike që ndikon në PBB e vendit ku pame se në PBB ajo mer 1.5 % nga

totali,duke zhvilluar edhe komunat në të cilën gjendet koncesioni,ku përfitimet janë të dyfishta edhe ne si konsumator, shteti ,si dhe subjekti ekonomik ku përfitimet mund të jenë:

- ❖ Zhvillimi i sektorit te industriesë- ku sot ajo mer pjes 8.31%
- ❖ Zhvillimin dhe zgjerimin e subjektit ekonomik,
- ❖ Hapja e vendeve të reja të punës ku sot sektori I minerale ka rritje të punësuarve me një pag mesatare prej 38 064 den
- ❖ Zhvillimi i teritorit ku gjendet koncesioni i burimit mineral
- ❖ Përfitimi i te ardhurave nga koncesioni ne rafshin komunal
- ❖ Përfitimi i të ardhurave nga koncesioni ne buxhetin e shtetit
- ❖ Zhvillimi i aktivitetit ekonomik
- ❖ Zgjerimi i eksportit sepse pjesa me e madhe eksportohet
- ❖ Rritja e Bruto prodhimit ne vend

Ku gjatë marjes së Tenderit për koncesionet e burimeve minerale ku Kompania përvec se paguan tarifat për shfrytezimin e sipërfaqes dhe tarifat e eksploatimit në m³,ajo realizon përfitime të shumta si subject ekonomik duke I mbuluar kostot e saj,dhe duke rritur përfaqesimin e saj si dhe duke eksportuar produktet ne vendet tjera. Gjatë analizës së dhënies së koncesioneve dhe kompanive fituese vërejm se një numër I madh I koncesioneve u jepen firmat që kanë kredibilitet më të lartë ku firmat me performance të ulët ekonomike mbeten në shifra të vogël në përfitimin e koncesioneve

Tabela 10. Nr I koncesioneve të fituara nga subjektet ekonomike

subjekti ekonomik	Koncesione
ЕЛЕМ - Скопје-РЕк Битола	3
ЕУРОМАКС РЕСОУРЦЕС ДОО Скопје	2
ГД Гранит	9
Цементарница “Усје” АД Скопје	8
Огражден – Струмица	2
Кнауф-Радика – Дебар	5
Миса-МГ – Скопје	5
Ренова – Тетово	3
Кожувчанка ДОО Кавадарци	3
Рудпроинг – Мустакас	3
КРИН-КГ ДОО Прилеп	4
Победа, с.Ботун	4
Емви-Комерц	4
Жикол – Струмица	4
ЈАВНОТО ПРЕТПРИЈАТИЕ ЗА ДРЖАВНИ ПАТИШТА	9
БАУЕР БГ ДОО Скопје	3

Burimi:Kalkulimi i autorit

